

ENTI RREGULLATOR I UJIT I SHQIPËRISË

Raporti i Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime

2016



Publikuar nga Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë (ERRU)
Rr. “VIKTOR EFTIMIU” Nd. 1Njësia Administrative Nr.5, 1001
Tiranë, Shqipëri

E-mail: public@erru.al
Tel: +355 4 2258046
www.erru.al

©Enti Rregullator i Ujit i Shqipërisë

Qershor 2017

Përmbajtja

Shkurtime	2
Përmbledhje e Raportit	3
Hyrje	9
1. Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca	12
1.1 Të Përgjithshme	12
1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin	13
1.3 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK	16
2. Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime	18
2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK	18
2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU	19
2.3 Saktësia dhe Besueshmëria e të Dhënave	20
2.4 Treguesit Kryesorë të Performancës	21
2.4.1 Uji Pa të Ardhura	21
2.4.2 Mbulimi i Kostove O&M	26
2.4.3 Mbulimi i Kostove Totale	32
2.4.4 Norma e Arkëtimit	39
2.4.5 Niveli i Matjes	45
2.4.6 Efiçenca e Stafit	53
2.4.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë	59
2.4.8 Mbulimi me Kanalizime	67
3. Tema e Veçantë: Reforma në Sektorin UK, Zbatimi i VKM nr. 63, datë 27.01.2016	71
4. Konkluzione	76
5. Aneksë: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura	77

Shkurtime

ERRU	Enti Rregullator i Sektorit të Furnizimit me Ujë dhe Largimit e Përpunimit të Ujërave të Ndotura
UK	Ujësjiellës Kanalizime
KKRR	Komisioni Kombëtar Rregullator
SHA	Shoqëri Aksionare
MTI	Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës
AKUK	Agjencia Kombëtare e Ujësjiellës Kanalizimeve
NJMB	Njësia e Monitorimit dhe Benchmark
NJQV	Njësitë e Qeverisjes Vendore
TKP	Treguesit Kryesore të Performancës
ITUN	Impiant i Trajtimit të Ujërave të Ndotura
O&M	Kosto Operative dhe Mirëmbajtje
RTA	Reforma Administrative Territoriale

Përmbledhje e Raportit

Hartimi i Raportit të Performancës së Sektorit UK 2016

Raporti i Performancës si instrument informimi dhe transparence

Raporti i Performancës së shoqërive UK hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Raporti nuk përbën thjesht një dokument statistikor krahasimi me vitet paraardhëse por analizon dhe paraqet tendencën e performancës të të gjithë shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri duke nxjerrë në pah problematikën dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-financiare të tyre. Vlerësimi i performancës së sektorit UK dhe shoqërive të licencuara që operojnë në të, i cili ka filluar që nga viti 2011, tashmë është një nga raportimet e vazhdueshme periodike që përgatit ERRU.

Raporti i Performancës analizon sektorin UK dhe jep rekomandime.

Raporti jep një pasqyrë të qartë të performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve, analizon shkaqet e performancës së dobët, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko ekonomike të performancës së shoqërive. Nga ana tjetër të gjithë aktorët e interesuar shohin në të progresin e arritur në sektorin e ujësjellës kanalizime dhe vlerësojnë performancën e shoqërisë së tyre lokale. Ky shërben si një element transparence i shoqërive ndaj konsumatorit, që ky i fundit të rrisë kërkesën e llogarisë për rritjen e cilësisë së shërbimeve ndaj tyre.

Raporti i Performancës duhet hartuar në kohë

Komisioni Kombëtar Rregullator ashtu siç dhe është shprehur në Raportin e Aktivitetit Vjetor 2016 të ERRU-së ka bërë përpjekjet maksimale që ky raport për herë të parë të mbyllet brenda 6-mujorit të parë të vitit 2017. Pavarësisht vështirësive që paraqet situata aktuale e shoqërive sa i përket saktësisë së të dhënave për shkak të riorganizimit të sektorit, përpjekja për të shkurtuar në maksimum afatin e paraqitjes së këtij raporti rrjedh nga domosdoshmëria që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit 2017 për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2016.

Reforma në Sektorin e Ujësjellës Kanalizimeve

Reforma në sektor një sfidë që duhet përballuar

Viti 2016 ka qenë viti i fillimit të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Riorganizimi i shoqërive UK sipas VKM Nr. 63, datë 27.01.2016 në përputhje me ndarjen e re administrative territoriale sipas parimit një bashki një shoqëri UK duhej të ishte mbyllur deri në fund të

vitit 2016. Duke patur parasysh përfshirjen e sistemeve rurale në zonën e shërbimit të UK, riorganizimi i sektorit përbën një sfidë mjaft të madhe për shoqëritë dhe bashkitë që të ruajnë apo sigurojnë qëndrueshmërinë financiare duke ofruar shërbime me cilësi për të gjithë konsumatorët. Reforma në këtë drejtim ka rezultuar problematike dhe ka ecur me ritme mjaft të ngadalta dhe në terren paraqet vështirësi të karakterit burokratik dhe ligjor për një zbatim të plotë e efikas të saj.

Vështirësitë për tu regjistruar në QKB

Mjaft shoqëri nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e reformës për tu regjistruar në QKB sipas zonës së re të shërbimit dhe të aseteve të shtuara në përputhje me ndarjen e re administrative, për shkak të borxheve të trashëguara, sistemeve që administroheshin më parë nga ish- komunat, si dhe mungesën e dokumentacionit për të bërë vlerësimin e tyre.

Zonat e reja rurale barrë e re financiare për shoqëritë UK

Zonat e reja rurale të përfshira në zonat e reja të shërbimit të shoqërive UK përbëjnë një barrë shtesë financiare meqenëse ato përfaqësojnë shpenzime operimi shtesë dhe njëkohësisht të ardhura më të vogla nga konsumatorët për shkak të tarifave mjaft të ulëta që aplikoheshin më parë në këto zona, si edhe nga shkalla e ulët e mbledhjes së faturave.

Mungesa e kapaciteteve profesionale në pozicionet kyçe

Problem tjetër që haset veçanërisht në bashkitë dhe shoqëritë UK relativisht të vogla dhe në zona të largëta mbetet sigurimi i kapaciteteve profesionale në pozicionet kyçe të menaxhimit të shoqërive UK në përputhje me kërkesat për kualifikime që legjislacioni parashikon për këto pozicione.

Bashkitë janë në kushte të ndryshme për zbatimin e reformës

Theksohet fakti që jo të gjitha njësitë vendore dhe shoqëritë UK janë në kushte të njëjta në lidhje me problematikat e zbatimit të reformës të përmendura më sipër. Megjithatë nëse bashkitë dhe shoqëritë UK angazhohen seriozisht ato arrijnë të përmbushin në kohë detyrimet në zbatim të reformës duke ofruar dhe mbuluar me shërbimet e ujësjetllës kanalizimeve të gjithë territorin mbas RAT. Në këtë grup bëjnë pjesë shoqëritë Sh.a UK Belsh, Sh.a UK Malësi e Madhe dhe Sh.a. UK Elbasan Qytet.

Zbatimi i reformës kërkon angazhimin e duhur

Si konkluzion, konstatohet që zbatimi i reformës kërkon një angazhim më të madh të bashkive, shoqërive të UK dhe të institucioneve të tjera në varësi të qeverisë qendrore që kanë lidhje me sektorin. Ndihet nevoja e plotësimit me akte të tjera nënligjore dhe administrative, si dhe e instrumenteve dhe mjeteve financiare për zgjidhjen e problemeve të cituara më sipër.

Hartimi i një Plani Biznesi 5 Vjeçar

Shoqëritë e riorganizuara duhet të shohin si prioritet hartimin e një Plani Biznesi 5 vjeçar me planet e veprimit përkatëse për përmirësimin e treguesve të performancës, ku përfshihet veçanërisht një program investimesh fizike, programi i lidhjeve të paligjshme, program i instalimit të ujëmatësve, përmirësimit të normës së arkëtimit etj.

Performanca e Sektorit Ujësjiellës Kanalizimeve

Performanca e sektorit të ujësjiellës kanalizimeve jepet në mënyrë të përmbledhur në Tabelën 1 bazuar në Treguesit Kryesorë të Performancës që ERRU përdor për të vlerësuar performancën e shoqërive UK.

Tabela 1. Performanca e Sektorit të Ujësjiellës Kanalizime në vitet 2014, 2015 dhe 2016

Treguesit e Performancës	2014	2015	2016	Tendenca e Performancës	Benchmark e Performancës së Mirë të ERRU	Objektivat e Strategjisë së Sektorit viti 2016
Uji Pa të Ardhura (%)	67.2	67	67.1	↘	30	45
Mbulimi i Kostove O&M (%)	122.5	102	117.9	↗	100	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	87	79	89.8	↗	80	78
Norma e Arkëtimit (%)	91	92	91.5	↘	82	96
Niveli i Matjes (%)	61.2	64	64.6	↗	85	80
Efienca e Stafit (staf/1000 lidhje)	5.49	5.53	5.34	↗	4/6/10	n/a
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	12.1	12.1	12.3	↗	18	18
Cilësia e Ujit të Pijshëm	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Mbulimi me Kanalizime (%)	51	50	50.7	↗	75	87
Mbulimi me Furnizimi me Ujë (%)	80.8	81	79.4	↘	n/a	93

Shënim: Burimi informacionit: AKUK

Shoqëritë UK në proces riorganizimi

Të dhënat për vlerësimin e performancës së sektorit janë bazuar në raportimet e të gjitha shoqërive UK pranë AKUK për vitin 2016. Për mjaft shoqëri UK, është e vështirë që të gjykohej performanca dhe tendenca e tyre krahasuar me një vit më parë, sepse gjatë vitit 2016 ato kanë qenë akoma në proces ose kanë përfunduar procedurat e riorganizimit në përputhje me reformën, kështu që raportohen të dhëna dhe tregues performance për zonën e re të shërbimit dhe që nuk kanë bazë krahasimi.

Pasaktësia dhe niveli i besueshmërisë së

Edhe këtë vit gjatë analizës së të dhënave që merren nga AKUK dhe nga bilancet financiare të shoqërisë dorëzuar pranë ERRU për vitin 2016, konstatohet që të dhënat në mjaft raste janë paradoksale dhe

të dhënave kontradiktore. Ky fakt reflektohet veçanërisht në bilancet e ujit që shoqëritë dorëzojnë pranë ERRU-së, të cilat hartohen në mënyrë empirike dhe sipërfaqësore për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë. Kjo sjell si pasojë që treguesi kryesor i performancës, Uji Pa të Ardhura rezulton me nivel të lartë pasaktësie. Hartuesit e Raportit kanë bërë përpjekjet maksimale në analizën e të dhënave për të përjashtuar në konkluzionet e tij pjesën e të dhënave që nuk kanë një bazë justifikimi në lidhje me vërtetësinë e tyre për të eliminuar vlerësimet e gabuara të performancës së shoqërive në veçanti dhe të gjithë sektorit në përgjithësi.

Sektori në gjendje performance stanjacioni Treguesit e Performancës së Sektorit të UK për vitin 2016 tregojnë për një gjendje stanjacioni të ecurisë së tij. Cilësia e shërbimit që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë (mesatarisht 12 orë/ditë), si dhe treguesi i Ujit Pa të Ardhura (67%) krahasuar me vitin 2015 mbeten në vlera të pandryshueshme dhe të pakënaqshme. Norma e Arkëtimit (91.5%) mbetet në vlera të larta dhe pothuajse e pandryshuar, ndërkohë që performanca financiare e përfaqësuar nga treguesit e performancës së mbulimit të kostove të O&M dhe ato totale kanë një përmirësim me rreth 10%.

Paraqitet shqetësuese sidomos treguesi i Ujit Pa të Ardhura që vazhdon të jetë në nivele të papranueshme (67.1 %). Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë jo vetëm nuk gjeneron të ardhura, por rrit edhe kostot e shërbimit të furnizimit me ujë sidomos në drejtim të kostove të energjisë elektrike. Nga ana tjetër përmirësimi i këtij treguesi lidhet mjaft me treguesin e cilësisë së shërbimit për zgjatjen e kohës së furnizimit me ujë.

Përmirësimi i gjendjes financiare të shoqërisë i pambështetur në argumente Duke patur parasysh që treguesit e Ujit Pa të Ardhura dhe Norma e Arkëtimit nuk janë përmirësuar, si edhe tarifat e shërbimeve të UK nuk kanë patur ndonjë rritje të konsiderueshme gjatë vitit 2016, i vetmi argument i pranueshëm që mund të justifikojë përmirësimin e performancës financiare të shoqërive UK është zvogëlimi i shpenzimeve të O&M. Reduktimi i kostos së shpenzimeve të O&M mesatarisht me vlerën 10% është vështirë për të qenë i vërtetë dhe përgjithësisht nuk mbështetet me argumente nga shoqëritë UK. Në këtë rast edhe njëherë del në pah problemi i saktësisë dhe i besueshmërisë së të dhënave që raportohen, problem i cili duhet marrë në konsideratë për zgjidhje më seriozisht nga institucionet që janë përgjegjëse dhe të ngarkuara nga ligji për monitorimin e tyre.

Sektori është i pa balancuar Vlerat mesatare të Treguesve Kryesorë të Performancës për të gjithë sektorin UK fshehin një aspekt tjetër problematik të sektorit, i cili

financiarisht paraqitet i pa balancuar në drejtim të performancës financiare të dobët dhe të cilësisë së shërbimit të pakënaqshme që paraqesin shoqëritë UK të vogla dhe të mesme (Grupi II-të dhe III-të).

Sektori është mjaft i fragmentarizuar Në këtë realitet ndikon dhe natyra mjaft e fragmentarizuar e sektorit me rreth 60 shoqëri UK, ku vetëm shoqëritë e mëdha si UK Tirana dhe UK Durrës (Grupi i I-rë) mbulojnë rreth gjysmën e popullsisë rezidente sipas të dhënave të popullsisë nga Censusi i vitit 2011. Kuptohet që perspektiva e afërt dhe afatmesme për rritjen e performancës financiare të shoqërive të mesme dhe të vogla është agregimi (shkrirja) i tyre në shoqëri më të mëdha për të rritur efektin e ekonomisë së shkallës. Agregimi duhet të realizohet me baza vullnetare dhe me incentiva nga qeveria qendrore.

Shoqëritë UK janë të mbingarkuara me staf Në lidhje me treguesin e performancës së Eficencës së Stafit (mesatarisht 5,34 staf/1000 lidhje) në përgjithësi shoqëritë janë të mbingarkuara me staf. Krahas marrjes në punë të një personeli mbi nevojat reale për operimin dhe menaxhimin e shoqërive dhe sistemeve të ujësjellës kanalizimeve, këtë tregues e rondon edhe numri i madh i punonjësve shtesë si roje objekteve për operimin e depove të ujit, si edhe të puseve dhe stacioneve të pompimit. Kjo është një kërkesë ligjore për garantimin e sigurisë ndaj shëndetit publik. Ky element mund të ri konsiderohet nga ana ligjore, sepse garancia e sigurisë publike për këto objekte mund të realizohet edhe me masa teknike dhe logjistike, dhe të tjera masa ad-hoc rast pas rasti.

Konkluzione

- Ndihet nevoja e përshpejtimin të reformës në sektor. Për këtë kërkohet një angazhim më i madh i bashkive, shoqërive të UK dhe të institucioneve të tjera në varësi të qeverisë qendrore që kanë lidhje me sektorin duke vendosur afate dhe klauzola që parashikojnë sanksione në rast mosrespektimi të tyre.
- Në kuadër të reformës së sektorit, aktorët vendorë dhe qendrorë të fushës së ujësjellës kanalizimeve, si dhe institucionet e tjera që lidhen me këto shërbime, të intensifikojnë punën për ndërgjegjësimin e popullsisë me anë të mediave kryesisht vizive në emisione të organizuara posaçërisht për këtë qëllim.
- Të eliminohen barrierat për regjistrimin e shoqërive UK të riorganizuara në përputhje me reformën që në disa raste paraqiten me doza formale e të tepërta.
- Duke patur parasysh problemet e sektorit në lidhje me kundravajtësit dhe abuzuesit, ndihet nevoja e plotësimit me akte të tjera nënligjore dhe administrative, si dhe e

instrumentave përkatës për zbatimin e tyre për një zbatim efikas të reformës.

- Të përmirësohet mekanizmi i vlerësimit-planifikim-alokim fondesh nga qeveria qendrore për një periudhë tranzicioni që shoqëritë e riorganizuara UK të mund të përballojnë kostot shtesë nga rritja e zonës së tyre të shërbimit me sistemet e furnizimit me ujë që administroheshin më parë nga ish komunat.
- Rishikimi i legjislacionit për plotësimin e kërkesave ndaj stafit kyç të shoqërive UK që të jenë të diferencuara për shoqëritë e mëdha të mesme dhe të vogla.
- Është e nevojshme që qeveria qendrore të planifikojë dhe alokojë fondet përkatëse për të pajisur të gjithë sistemet e furnizimit me ujë në sektor me ujëmatës të mëdhenj që mundësojnë hartimin e bilanceve të sakta të ujit që krijojnë mundësinë e njohjes së gjendjes reale të kërkesës për ujë dhe administrimin e saj.
- Duke patur parasysh për shoqëritë UK rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare, si instrumente udhërrëfyes me plane veprimi për përmirësimin e performancës së tyre, ndihet e nevojshme që kjo të jetë një prerogativë ligjore për shoqëritë, sidomos për shoqëritë me mundësi të kufizuara financiare, qeveria qendrore të incetivojë financimin e hartimit të tyre.
- Duke patur parasysh fragmentarizimin e sektorit ndihet e nevojshme që qeveria qendrore të shohë si prioritet të afërt fillimin e realizimit të strategjisë së agregimit të shoqërive me një ose dy projekte pilot, aty ku shihet më i mundshëm suksesi, duke respektuar kriteret e vullnetit të lirë të pronarëve si dhe me incentiva nga qeveria qendrore.

Hyrje

Hartimi dhe prezantimi i raportit Vjetor të Performancës së shoqërive UK më parë është realizuar në periudhën Tetor-Nëntor. Raporti i performancës për vitin 2016, për herë të parë prezantohet nga ERRU brenda 6-mujorit të parë të vitit 2017. Përpykja për të shkurtuar në maksimum afatin e paraqitjes së këtij raporti rrjedh nga domosdoshmëria që t'i lihet shoqërive një kohë minimale e mundshme gjatë vitit 2017 për zbatimin e rekomandimeve që rrjedhin nga ky raport në lidhje me performancën dhe problematikën e sektorit në vitin 2016.

Raporti i Performancës së shoqërive UK hartuar nga ERRU është një instrument informimi dhe transparence ndaj publikut dhe gjithë aktorëve përfshirës në sektorin e ujit. Raporti nuk përbën thjesht një dokument statistikor krahasimi me vitet paraardhëse por analizon dhe paraqet tendencën e performancës të të gjithë shoqërive të ujësjellës kanalizimeve në Shqipëri duke nxjerrë në pah problematikën dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-financiare të tyre.

Raporti jep një pasqyrë të qartë të performancës së sektorit të ujësjellës kanalizimeve, analizon shkaqet e performancës së dobët, si dhe jep rekomandime për përmirësimin e treguesve tekniko-ekonomike të performancës së shoqërive. Nga ana tjetër të gjithë aktorët e interesuar shohin në të progresin e arritur në sektorin e ujësjellës kanalizimeve dhe vlerësojnë performancën e shoqërisë së tyre.

Enti Rregullator i Ujit është një institucion i pavarur publik, përgjegjës për rregullimin dhe monitorimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura në nivel kombëtar. Si institucion i pavarur ERRU ka detyrën që të jetë sa më objektiv në vlerësimet e tij për sektorin e UK, pjesë e rëndësishme e të cilit është hartimi i Raportit Vjetor 2016 të Performancës të Sektorit UK.

Hartimi me objektivitet i këtij raporti merr rëndësi të veçantë në stadin aktual për të reflektuar me saktësi dhe objektivitet gjëndjen, problemet dhe sfidat e mëdha që ka sektori në zbatim të reformës së nisur nga Qeveria Qendrore me anë të VKM nr. 63, në 27 Janar të vitit 2016.

Raporti analizon me imtësi performancën e çdo shoqërie UK dhe paraqet tendencën e performancës së të gjithë këtyre shoqërive duke nxjerrë në pah problematikën dhe rekomandimet përkatëse për përmirësimin e treguesve tekniko-financiarë të tyre.

Treguesit e Performancës së shoqërive të UK për vitin 2016 tregojnë për një gjendje stanjacioni të performancës së tyre. Cilësia e shërbimit që shoqëritë i ofrojnë konsumatorëve në drejtim të kohës së furnizimit me ujë, si dhe treguesi i Ujit Pa të Ardhura krahasuar me vitin 2015 mbeten në vlera të pandryshueshme dhe të pakënaqshme.

Zbatimi i reformës së sektorit po ecën me ritme mjaft të ngadalta dhe në terren paraqet vështirësi të karakterit burokratik dhe ligjor për një zbatim të plotë e efikas të tij. Mjaft shoqëri nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e reformës për tu regjistruar në QKB sipas zonës së re të shërbimit dhe të

aseteve të shtuara në përputhje me ndarjen e re administrative, për shkak të borxheve të trashëguara të sistemeve që administroheshin më parë nga ish komunat. Zonat e reja rurale të përfshira në zonat e reja të shërbimit të shoqërive UK përbëjnë një barrë shtesë financiare meqenëse ato përfaqësojnë shpenzime operimi shtesë dhe njëkohësisht të ardhura më të vogla nga konsumatorët për shkak të tarifave mjaft të ulëta që aplikoheshin më parë në këto zona, si edhe nga shkalla e ulët e mbledhjes së faturave.

Problem tjetër që haset veçanërisht në bashkitë dhe shoqëritë UK relativisht të vogla dhe në zona të largëta mbetet siguri i kapaciteteve profesionale në pozicionet kyçe të menaxhimit të shoqërive UK në përputhje me kërkesat për kualifikime që legjislacioni parashikon për këto pozicione.

Në përgjithësi ndihet mungesa e një programi të investimeve fizike me alokimin e fondeve përkatëse që ti përgjigjet kërkesave të rritjes së përmirësimit të cilësisë së shërbimeve, si dhe rritjes së përqindjes së popullsisë që kanë akses në këto shërbime.

Në sektor ndihet nevoja që shoqëritë UK të jenë të pajisura me Plane Biznesi 5 Vjeçare si domosdoshmëri në përcaktimin e problematikave dhe të dobësisë së performancës së tyre, si edhe të rrugëve dhe planeve të veprimit përkatëse për përmirësimin e këtyre treguesve. Planet e biznesit, planet e menaxhimit të aseteve, programet e lidhjeve ilegale janë disa nga instrumentet orientuese kryesore për shëndoshjen e gjendjes financiare të shoqërive UK, si edhe për përcaktimin e nevojave reale për investime fizike. Pajisja me Plane Biznesi 5 Vjeçare e shoqërive UK, tashme duhet të konsiderohet si domosdoshmëri apo prerogativë ligjore, jo vetëm si instrument për mirë menaxhimin e shoqërive, por edhe si argument kryesor justifikues kur ato aplikojnë për tarifa të reja tek ERRU-ja.

Eksperiencia e deritanishme tregon se zbatimi i reformës kërkon një angazhim më të madh të bashkive, shoqërive të UK dhe të institucioneve të tjera në varësi të qeverisë qendrore që kanë lidhje me sektorin. Ndihet nevoja e plotësimit me akte të tjera nënligjore dhe administrative, si dhe e instrumenteve dhe mjeteve financiare për zgjidhjen e problemeve të cituara më sipër.

Theksohet fakti që jo të gjitha njësitë vendore dhe shoqëritë UK janë në kushte të njëjta në lidhje me problematikat e zbatimit të reformës. Disa bashki dhe shoqëri UK janë angazhuar seriozisht dhe kanë përmbushur në kohë detyrimet në zbatim të reformës. Në këtë grup bëjnë pjesë shoqëritë Sh.a UK Belsh, Sh.a UK Malësi e Madhe dhe Sh.a UK Elbasan Qytet të cilat kanë demonstruar se nëse pushteti lokal dhe shoqëritë UK angazhohen seriozisht arrijnë të përmbushin kushtet për të ofruar dhe mbuluar me shërbimet e ujësjellës kanalizimeve në të gjithë territorin mbas RAT.

Nga ana tjetër tashme është i mirënjohur fakti se ka shoqëri UK në vendin tonë që janë pararojë e performancës jo vetëm tek ne por në mbarë gadishullin e Ballkanit, si Ujë Korrë sha. që është e qëndrueshme financiarisht dhe që ofron shërbime të një cilësie të lartë për konsumatorët me një vazhdimësi furnizimi me ujë 24/7, me presionin e duhur, bakteriologjikisht të pastër dhe me çmime të përballueshme. Kjo shoqëri shërben jo vetëm si shembull pozitiv i arritjes në sektor,

por tregon për mundësitë reale që kanë shoqëritë me performancë të dobët për të përmirësuar treguesit tekniko ekonomike të tyre.

Si konkluzion përmirësimi i performancës së sektorit lidhet ngushtësisht me një angazhim më të rëndësishëm të të gjithë aktorëve që përfshihen në të dhe me një plotësim dhe intensifikim më të madh të reformës në ngjashmëri me atë të realizuar më parë në sektorin energjitik.

1. Performanca e Përgjithshme e Sektorit dhe Tendenca

1.1 Të Përgjithshme

Në tabelën 2. të mëposhtme është paraqitur performanca e përgjithshme e sektorit për vitin 2016 për 10 TKP si dhe tendenca e performancës krahasuar me arritjet e vitit 2015 dhe objektivit të performancës së mirë të ERRU dhe objektivit strategjik për sektorin.

Tabela 2. Performanca e Sektorit të ujësjellës kanalizimeve në vitet 2014, 2015 dhe 2016

Treguesit e Performancës	2014	2015	2016	Tendenca e Performancës	Benchmark e Performancës së Mirë të ERRU	Objektivat e Strategjisë së Sektorit viti 2016
Uji Pa të Ardhura (%)	67.2	67	67.1	↘	30	45
Mbulimi i Kostove O&M (%)	122.5	102	117.9	↗	100	100
Mbulimi i Kostos Totale (%)	87	79	89.8	↗	80	78
Norma e Arkëtimit (%)	91	92	91.5	↘	82	96
Niveli i Matjes (%)	61.2	64	64.6	↗	85	80
Efiçenca e Stafit (staf/1000 lidhje)	5.49	5.53	5.34	↗	4/6/10	n/a
Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë (orë/ditë)	12.1	12.1	12.3	↗	18	18
Cilësia e Ujit të Pijshëm	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a	n/a
Mbulimi me Kanalizime (%)	51	50	50.7	↗	75	87
Mbulimi me Furnizimi me Ujë (%)	80.8	81	79.4	↘	n/a	93

Shënim: Burimi informacionit: AKUK

Siç edhe shihet nga tabela nivelet e treguesve kryesorë të performancës për sektorin dhe tendenca e tyre është e ndryshme.

Situata aktuale vështirëson një gjykim real dhe të plotë të performancës së sektorit, pasi shoqëritë UK janë duke kryer procedurat e riorganizimit gjë e cila ka ndikuar edhe në raportimin e të dhënave e për rrjedhojë edhe në përlogaritjen e treguesve.

Në mjaft raste llogaritja dhe analiza e treguesve të performancës ka qenë e vështirë në këtë periudhë tranzicioni të reformës në sektorin e ujit për shkak të zhdukjes së bazës së krahasimit nga ndryshimi i hartës së zonës së shërbimit dhe të klientëve të saj.

Në këtë kuptim nivelet e treguesve të performancës që jep tabela e mësipërme reflektojnë ndryshimet e ndodhura në sektorin UK në kuadër të reformës për riorganizimin e tij.

Një pjesë e shoqërive UK faktikisht janë duke kryer shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit të ujërave të ndotura edhe në zonat e reja, por juridikisht nuk kanë përfunduar procesin e kalimit në

pronësi të aseteve dhe regjistrimin si shoqëri e re në QKB. Këto shoqëri kanë raportuar të dhënat në lidhje me popullsinë në zonën e juridiksionit dhe atë të shërbyer, numrin e klientëve por nuk raportojnë të dhëna në lidhje me volumet e prodhimit, asetet, kostot etj, pasi kjo lidhet me procesin e transferimit.

Në rastet kur një shoqërie i largohen nga zona e juridiksionit disa zona dhe këto ju bashkohen një shoqërie tjetër të dhënat për këto zona, duke qenë se juridikisht procesi i transferimit nuk ka përfunduar, raportohen nga të dy shoqëritë.

1.2 Analiza e Treguesve Kryesorë të Performancës për Sektorin

Në lidhje me Treguesit Kryesorë të Performancës për të gjithë sektorin e ujësjellës kanalizimeve vërehet:

"Mbulimi me Shërbimet e Furnizimit me Ujë" Referuar raportimeve të bëra nga shoqëritë UK rezulton se krahasuar me një vit më parë treguesi i "mbulimi me ujë" ka patur tendencë negative dhe "mbulimi me kanalizime" është përmirësuar. Shkaku kryesor i kësaj performance nëse analizojmë të dhënat rezulton se numri i popullsisë në zonën e juridiksionit dhe numri i popullsisë së shërbyer është rritur si për shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë me kanalizime. Popullsia në zonën e juridiksionit për të gjithë shoqëritë është rritur me rreth 500 mijë banorë, popullsia që faktikisht furnizohet me ujë është rritur me rreth 250 mijë banorë, ndërsa popullsia me lidhje në sistemin e kanalizimeve është rritur me rreth 220 mijë banorë.

"Mbulimi i Kostos Direkte të O&M" dhe "Mbulimi i Kostos Totale". Progres i mirë është shënuar për sa i përket dy treguesve të mbulimit të kostos, "Mbulimi i kostos së O&M dhe "Mbulimi i kostos Totale". Sektori ka tejkaluar objektivat e performancës së mirë të ERRU si dhe objektivat strategjikë të qeverisë. Këto shifra të përmbledhura gjithsesi fshehin performancën e dobët të disa shoqërive, kryesisht të vogla dhe të mesme, të ardhurat e të cilave janë të pamjaftueshme për të mbuluar qoftë edhe gjysmën e kostove të tyre. Gjithsesi performanca e këtij treguesi duhet parë me rezervë sepse nëse shohim që tendenca e treguesit të normës së arkëtimit ka rënie, atëherë përmirësimi i performancës financiare të shoqërive mund të shpjegohet vetëm me reduktimin e shpenzimeve, fakt i cili për impaktet financiare në ato vlera që jepen në këto tregues vështirë se mund të pranohet. Kjo evidenton problemin e saktësisë dhe të besueshmërisë së të dhënave, problem i cili akoma nuk po zgjidhet që përfundimisht të kemi një nivel të kënaqshëm të besueshmërisë dhe të saktësisë së të dhënave që raportohen nga shoqëritë.

"Norma e Arkëtimit" Një efikasitet i mirë në arkëtimin e të ardhurave ka të bëjë me fuqizimin financiar të shoqërisë që ndikon drejtpërdrejtë në aftësinë paguese të shoqërisë. Rezultatet e performancës së normës së arkëtimit janë zbehur pak krahasuar me vitin 2015 pasi niveli i arritur i "efikasitetit të arkëtimit" është ulur me 0.5%. Sektori nuk ka arritur objektivin strategjik por ka kaluar atë të performancës së mirë të vendosur nga ERRU. Niveli i këtij treguesi pasqyron nivelin mesatar të arkëtimit të të ardhurave në sektor, por kjo nuk do të thotë se të gjitha

shoqëritë kanë nivel të mirë të këtij treguesi. Mjaft shoqëri kanë një nivel të lartë arkëtimi, por për shumë shoqëri norma e arkëtimit mbetet e ulët në vlera totale për shkak të borxheve të këqija të trashëguara në vite. Problemit të borxheve të këqija për debitorë të cilët prej vitesh nuk shlyejnë debitë ndaj shoqërive UK i duhet dhënë një zgjidhje e përgjithshme ligjore në nivel qendror.

"Eficienca e Stafit" Eficienca e Stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efikasitetit në punë, dhe në këtë mënyrë të rritjes së efikasitetit të përgjithshme të shoqërisë. Theksohet fakti që energjia elektrike dhe fuqia punëtore janë dy elementët kryesorë të kostove operacionale që shoqëritë UK duhet të mbulojnë gjatë aktivitetit të tyre.

Në pamje të parë nëse i referohemi këtij treguesi nga eksperiencia botërore dhe në rajon, përgjithësisht shoqëritë UK operojnë me një numër të lartë punonjësish Vetëm pak shoqëri, si UK Korçë plotësojnë kushtin ku efikasiteti i stafit është në nivele bashkëkohore.

Megjithatë sa i përket këtij treguesi në vlerësimin individual të shoqërive duhen marrë parasysh specifikat e operimit dhe ofrimit të shërbimit të tyre. Në mjaft raste ky tregues është artificialisht i lartë për shkak të veçorive që paraqesin komponentët e sistemeve të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve në plotësim të detyrimeve ligjore në garantim të sigurisë së këtyre veprave me personel roje. Kështu në ato zona shërbimi ku sistemet e furnizimit me ujë kanë një numër të madh deposh, pusesh etj., shoqëritë paraqesin në organigramën e tyre një numër mjaft të madh punonjësish për të mbuluar shërbimin e sigurisë në këto objekte. Ky problem duhet konsideruar për ti dhënë zgjidhje teknike sigurisë së këtyre objekteve për të mos rritur artificialisht dhe në mënyrë të panevojshme kostot e fuqisë punëtore në shoqëritë UK.

Gjithsesi shoqëritë UK kanë nevojë të rrisin në mënyrë të konsiderueshme përpjekjet e tyre për përmirësimin e efikasitetit të stafit duke justifikuar çdo pozicion pune në organigramë dhe të shoqëruar me përshkrim të detajuar të punës.

"Uji Pa të Ardhura" (UPA) Treguesi "Uji Pa të Ardhura" për vitin 2016 vazhdon të jetë në nivele mjaft të larta (67.1%) duke mos paraqitur tendenca uljeje. Kjo tregon se pjesa më e madhe e ujit të prodhuar humbet, për rrjedhojë jo vetëm nuk gjeneron të ardhura e pritshme, por rrit edhe kostot e shërbimit të furnizimit me ujë në drejtim të konsumit kryesisht të energjisë elektrike. Ky tregues të paktën për katër vitet e fundit mbetet në nivele të njëjta dhe përbën shqetësimin kryesor në sektor. Reduktimi i UPA duhet të jetë përparësi e çdo shoqërie në mënyrë që ato të jenë të qëndrueshme financiarisht.

Ky tregues reflektohet qartë në Bilancet e Ujit që hartojnë shoqëritë UK. Bilanci i Ujit është një instrument i rëndësishëm për evidentimin, vlerësimin e humbjeve që kanë origjinë faktorë teknikë (humbje teknike), si dhe ato që lidhen me menaxhimin, apo humbje administrative. Nga ana tjetër Bilancet e Ujit shërbejnë si bazë për hartimin e planeve të veprimit për reduktimin e UPA. Eksperiencia tregon që shoqëritë për reduktimin e UPA nuk duhet të presin vetëm sigurimin e fondeve për investimet e nevojshme për zëvendësimin e infrastrukturës së vjetruar që

do të reduktojnë humbjet fizike në sistem. Njëkohësisht ato duhet të hartojnë programe për reduktimin e humbjeve administrative që vijnë si rezultat i lidhjeve të paligjshme në sistem, nën faturimet, shpërdorimet për ujitje nga konsumatorët që nuk janë të pajisur me matës uji etj., të cilat kërkojnë fare pak ose nuk kërkojnë fonde të konsiderueshme për investime fizike.

Hartimi i Bilanceve të sakta të Ujit mbetet një problem mjaft shqetësues për shkak të mungesës së ujëmatësve të mëdhenj në pikat kyçe të sistemeve të furnizimit me ujë, si puse, stacione pompimi, depo, dhe zona të rrjeteve shpërndarëse. Mungesa e tyre është pengesë për të patur tregues performance reale në lidhje me UPA dhe gjendjen e humbjeve në sisteme, si elementë të domosdoshëm për mirë menaxhimin e sistemeve të furnizimit me ujë dhe të kërkesës për ujë. Pajisja 100% e të gjithë komponentëve kyç të sistemeve të furnizimit me ujë duhet të jetë prioritet bazë i shoqërive UK dhe i mundësisë të financimit të tyre nga qeveria qendrore.

"Niveli i pajisjes me Ujëmatës" Shoqëritë UK edhe në vitin 2016 kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit, duhet theksuar se ecuria e treguesit "niveli i matjes" në vite për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive. Megjithatë, në vitin 2016 numri i shoqërive të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët vazhdon të jetë i ulët. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur si për klientët familjarë edhe për ato jo familjarë, madje ka dhe një numër të kufizuar shoqërish për të cilat shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm. Pajisja me ujëmatës e gjithë sistemit duhet të jetë një nga objektivat kryesorë të shoqërive, si një element që lehtëson mjaft problemet e menaxhimit të kërkesës për ujë dhe uljes së shpërdorimeve dhe të mbikonsumit në sisteme. Praktika e deritanishme ka treguar se shpërdorimet dhe mbikonsumi nga konsumatorët sidomos gjatë stinës së verës për ujitje, larje rrugësh etj, kapin vlera mjaft të larta që cenojnë furnizimin me ujë të një pjese të mirë të konsumatorëve të tjerë në zonën e shërbimit. Objektivi i performancës së mirë të ERRU dhe ai strategjik për sektorin për këtë tregues nuk është arritur.

Objektivi i pajisjes me matësve i të gjithë konsumatorëve është plotësisht i arritshëm nga shoqëritë UK dhe duhet të jetë një prioritet që duhet të mbështetet edhe nga qeveria qendrore. Eliminimi i praktikës "aforfe" dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësve në prodhim dhe individual duhet të jetë në fokus të punës së shoqërive. Mjaft shoqëri UK të paktën duhet të kishin përfunduar deri në fund të vitit 2010 (bazuar në dy vendime të Këshillit të Ministrave) instalimin e matësve për të gjithë klientët jo familjarë.

"Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë" Përsa i përket cilësisë së shërbimit ndaj klientëve, që matet me vazhdimësinë e shërbimit dhe cilësinë e ujit të pijshëm, performanca është e dobët. Përgjithësisht konsumatorët nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë. Mesatarja e orëve të furnizimit për sektorin 12.3 orë në ditë është më e ulët se sa objektivi i qeverisë për sektorin dhe niveli i performancës së mirë të ERRU. Shoqëritë ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar dhe kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 3-24 orë/ditë. Vetëm tre shoqëri ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur, përkatësisht Sh.a. UK Korçë Qytet, Sh.a. UK Pogradec dhe Sh.a. UK Librazhd.

Referuar të dhënave të vitit 2016, rezulton se popullsia që faktikisht furnizohet me ujë nga shoqëritë UK në fshat është rritur me rreth 28% krahasuar me vitin 2015. Kohëzgjatja e

furnizimit me ujë në këto zona është më e ulët se në zonat urbane, gjë e cila ka ndikuar edhe në rezultatin e përgjithshëm të këtij treguesi.

"Cilësia Bakteriologjike e Ujit" Janë dy parametra kryesorë që vlerësojnë cilësinë sanitare të ujit të pijshëm, standardet bakteriologjike (koliformet) dhe përqindja e klorit mbetës. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm nga magjistralet shpërndarëse të ujit i ka detyruar që pjesa më e madhe e konsumatorëve të instalojnë depozita uji individuale që nuk garantojnë siguri sanitare për cilësinë e ujit. Nga ana tjetër duke qenë se magjistralet shpërndarës nuk janë vazhdimisht të mbushura me ujë dhe nën presion, ato janë mjaft të ekspozuara ndaj intersektimit me ujërat e zeza në rastet e çarjeve të mundshme. Për sa më sipër në disa raste ofruesit e shërbimit nuk mund të garantojnë nga ana sanitare cilësinë e ujit për konsumatorët megjithëse cilësia e ujit në burim është e mirë.

Në lidhje me cilësinë e ujërave të ndotura që derdhen në ambientin pritës, me vënien në funksionim të impianteve situata ka ndryshuar ndonëse për një numër të kufizuar konsumatorësh. Në vend funksionojnë 8 impiante të trajtimit të ujërave të ndotura. Rritja e nivelit të trajtimit të ujërave të ndotura do të luajë një rol të rëndësishëm në mbrojtjen e mjedisit dhe ekosistemeve që çon në rritjen e përfitimeve ekonomike dhe rekreative nga turizmi, sidomos nga plazhet.

1.3 Nevoja për Investime Kapitale dhe Financimi i Sektorit UK

Investimet kapitale vazhdojnë të luajnë një rol të rëndësishëm në përmirësimin e situatës së sektorit. Në vitin 2016 si edhe në vitet paraardhëse, burimet kryesore të financimit, kanë qenë buxheti i shtetit dhe financimi nga donatorët e huaj në formën e huave apo granteve në raporte përafërsisht të barabarta. Këto investime janë fokusuar kryesisht në rehabilitimin e sistemeve të furnizimit ujësjellës kanalizime si edhe në ndërtimin e impianteve të trajtimit të ujërave të ndotura.

Nevojat për investime në sektorin UK paraqiten në mënyrë të detajuar në Masterplanin e Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime për Shqipërinë për periudhën 2011-2040 financuar nga KfW. Masterplani tregon një vlerë për financime fizike në sektor prej 6,7 miliard Euro, nevojë e cila duhet të përballohet e projektuar deri në vitin 2040. Kjo vlerë përkon mesatarisht me një nevojë për financim prej rreth 270 milion Euro në vit, në krahasim me financimin aktual të sektorit prej rreth 86milion Euro në vit.

Në Maj 2016 u hartua Strategjia Kombëtare e Financimit të Sektorit Ujësjellës Kanalizimeve në Shqipëri, e cila tregon rrugët e mundshme dhe reale të financimit të sektorit me 3T-të (Taksa, Transferta, Tarifa). Financimi i sektorit me 3T ka parasysh financimin nga burime të brendshme financiare të shoqërive të gjeneruara nga aktiviteti i saj, financime nga qeveria qendrore, dhe së fundi nga donatorët.

Elementi i ri në lidhje me realizimin e skemës së financimit të nevojave për investime fizike në sektor është mbulimi i një pjese të konsiderueshme të financimit nga vetë shoqëritë. Analiza në lidhje me përbalueshmërinë e pagesës nga konsumatorët referuar të ardhurave mesatare të tyre,

tregoi se ka mjaft hapësirë për rritjen e tarifave në mënyrë që të përmirësohet gjendja financiare e shoqërive për të gjeneruar të ardhura për të mbuluar një pjesë të nevojave për financim të tyre.

Rritja e tarifave dhe zbatimi me sukses i reformës në sektorin UK janë parakushti që të arrihet shëndoshja e gjendjes financiare të shoqërive.

Nga ana tjetër sektori paraqitet mjaft i fragmentarizuar me rreth 58 shoqëri UK, ku vetëm dy shoqëri UK Tirana dhe UK Durrës mbulojnë rreth 50% të popullsisë. Një tjetër element që lidhet me përmirësimin e performancës financiare të shoqërive duhet konsideruar agregimi, për të cilin objektivat e vendosura në Strategjinë Kombëtare të Ujësjetës Kanalizimeve janë akoma mjaft larg së realizuari. Fillimi i këtij procesi me një ose dy shembuj pilot suksesi agregimi duhet të realizohet paralel me reformën në sektor.

2. Analiza e Performancës për Shoqëritë Ujësjellës Kanalizime

2.1 Treguesit Kryesorë të Performancës sipas Grupimeve të Shoqërive UK

Edhe për vitin 2016, monitorimi dhe vlerësimi krahasues i performancës së shoqërive ujësjellës kanalizime bazohet në 9 tregues kryesorë të performancës të cituara më sipër dhe të miratuar nga Komisioni Kombëtar Rregullator. Njëpërmjet këtyre treguesve janë analizuar dhe vlerësuar drejtimit më të rëndësishme të punës së operatorëve duke na dhënë një pasqyrë gjithëpërfshirëse për nivelin e ofruar të shërbimeve.

Për të realizuar një vlerësim krahasues sa më real të performancës ndërmjet shoqërive, referuar dimensionit të tyre, pra numrit të lidhjeve të konsumatorëve që ato kanë, shoqëritë vlerësohen të ndara në tre grupe, si një mënyrë e mirë për të bërë dallimin ndërmjet shoqërive të mëdha apo të vogla (Tabela 3 dhe Tabela 4).

Tabela 3. Grupet e shoqërive

	Madhësia e shoqërisë (numri i lidhjeve)	Numri i shoqërive në grup
Grupi 1	> 15,000 lidhje ujësjellës	11
Grupi 2	3,000 - 15,000 lidhje ujësjellës	25
Grupi 3	< 3,000 lidhje ujësjellës	21

Tabela 4. Ndarja e shoqërive në tre grupe

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 1			U	Kurbin	7,459
UK	Tiranë	221,149	UK	Korçë (F)	6,657
UK	Durrës	77,870	UK	Patos	5,862
UK	Vlorë	48,174	UK	Himarë	5,535
UK	Fier	32,852	UK	Kukës	5,445
UK	Elbasan	31,395	UK	Peshkopi	5,407
UK	Berat - Kuçovë	26,881	UK	Librazhd	5,246
UK	Kavajë	24,767	UK	Belsh	5,048
UK	Shkodër	24,046	UK	Krujë	4,578
UK	Korçë	24,042	UK	Mallakastër	4,387
UK	Sarandë UK	17,461	UK	Burrel	4,385
U	Elbasan (F)	16,451	U	Gramsh	4,338
Grupi 2			U	Peqin	4,147
UK	Pogradec	14,512	UK	Tepelenë	4,111
UK	UK Lushnje (Q)	11,480	UK	Rrogozhinë	4,017
UK	Gjirokastrë (Q)	9,802	U	Selenicë	3,533
UK	Lezhë	9,369	U	Ura-Vajgurore	3,487
U	Lushnje (F)	8,204	U	Përmet	3,425
U	Shkodër (F)	7,735	U	Bilisht	3,296

Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)	Shërbimi	Shoqëria	Nr. i Lidhjeve (ujësjellës)
Grupi 3			U	Poliçan	1,505
U	Divjakë	2,909	U	Has	1,411
U	Çorovodë	2,889	U	Këlcyrë	1,368
U	Bulqizë	2,803	UK	Bashkia Pukë	1,115
UK	Delvinë	2,758	U	Vau Dejës	969
UK	Fushë-Krujë	2,685	UK	Libohovë	764
U	Tropojë	2,545	UK	Fushë Arrëz	611
U	Novoselë	2,312	UK	Rubik	574
UK	Ersekë	2,032	UK	Pukë fshat	524
UK	Orikum	1,961	U	Gjirokastër (F)	417
UK	Mirditë	1,959	UK	Krastë	414

Burimi ERRU

2.2 Analiza e Performancës në Lidhje me Objektivat e Vendosura nga ERRU

Për efekt të analizës për secilin TKP, ERRU ka përcaktuar objektivat e synuar (që duhet arritur nga shoqëritë UK) për vlerësimin performancës. Në grafikët e analizës së performancës së çdo treguesi vija e verdhë tregon nivelin e objektivit të synuar për arritjen e një performance të mirë; gjithçka poshtë vijës së kuqe tregon performancë të dobët. Segmenti ndërmjet dy vijave konsiderohet performancë e “pranueshme”, që tregon nga njëra anë përpjekjet e bëra nga shoqëritë dhe nga ana tjetër domosdoshmërinë për përmirësime të mëtejshme. Në tabelën 5 tregohen kufijtë minimalë dhe maksimalë të përcaktuar për secilin TKP, ndërsa grafiku 1 më poshtë është një shembull i grafikëve të analizës së TKP.

Figura 1: Shembull i Grafikëve të Analizës së TKP-ve




Tabela 5. Objektivat e synuar për treguesit kryesorë të performancës

Treguesit Kryesorë të Performancës		Objektivat e vendosur		
		Mirë	Pranueshëm	Dobët
1 – Mbulimi i Kostove O&M		≥ 100%	80 - 100%	≤ 80%
2 – Mbulimi i Kostos Totale		≥ 80%	50 - 80%	≤ 50%
3 – Norma e Arkëtimit		≥ 82%	60 - 82%	≤ 60%
4 – Efienca e Stafit (numri i stafit të shoqërisë që i shërben çdo 1000 lidhje) ¹	Grupi 1	≤ 4	4 - 6	≥ 6
	Grupi 2	≤ 6	6 - 10	≥ 10
	Grupi 3	≤ 10	10 - 15	≥ 15
5 – Uji pa të ardhura		≤ 30%	30 - 50%	≥ 50%
6 – Niveli i matjes		≥ 85%	n/a	<85
7 – Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë		≥ 18 orë/ditë	8 - 18 orë/ditë	≤ 8 orë/ditë
8 – Cilësia e Ujit të Pijshëm		≥ 95%	90 - 95%	≤ 90%
9 – Mbulimi me Kanalizime		≥ 75%	50 - 75%	≤ 50%

2.3 Saktësia dhe Besueshmëria e të Dhënave

Treguesit kryesorë të performancës janë përlogaritur mbi bazën e të dhënave të raportuara nga shoqëritë ujësjellës kanalizime në Njësinë e Monitorimit pranë AKUK. Saktësia, besueshmëria dhe kontrolli në kohë i të dhënave luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës së shoqërive prandaj ERRU e ka konsideruar shumë të rëndësishëm bashkëpunimin me Njësinë e Monitorimit për përmirësimin e sistemit të raportimit dhe verifikimit të të dhënave.

Për vitin 2016, vetëm nga verifikimi i të dhënave të raportuara nga shoqëritë në Nj. Monitorimit në lidhje me të ardhurat nga faturimi, kostot dhe arkëtimi i të ardhurave me të dhënat e bilanceve financiare për disa shoqëri rezultojnë me diferenca të mëdha. Konkretisht treguesit kryesorë të performancës si "Mbulimi i kostove O&M", "Mbulimi i kostos Totale" dhe "Norma e Arkëtimit" kanë rezultuar me ndryshime të theksuara për shoqëritë Sh.a UK Burrel, Sh.a UK Ersekë, Sh.a UK Bilisht, Sh.a UK Mirditë, Sh.a UK Korçë dhe Sh.a UK Elbasan.

ERRU, bazuar në të dhënat e bilanceve financiare dhe shkëmbimeve të mëtejshme të informacioneve me shoqëritë UK ka bërë përpjekje për saktësimin sa më të mundshëm të këtyre treguesve duke bërë korrigjimet përkatëse për vitin 2015 dhe 2016, dhe analizën e treguesve të sipërpërmendur e ka hartuar mbi bazën e këtyre të dhënave.

¹ Për TKP Efienca e Stafit, objektivi i benchmarking është më i lartë për shoqëritë e vogla, duke marrë parasysh faktin që shoqëritë më të mëdha (të cilat u shërbejnë zakonisht zonave me densitet popullsie më të madhe) e kanë më të lehtë të mbajnë më të ulët numrin e stafit për 1000 lidhje.

2.4 Treguesit Kryesore të Performancës

2.4.1 Uji Pa të Ardhura

Sasia e ujit që humbet, nga vëllimi total i ujit të prodhuar dhe që nuk u faturohet klientëve quhet "Ujë pa të Ardhura". Ky tregues ka ndikim të drejtpërdrejtë në qëndrueshmërinë financiare të shoqërive si dhe në mbulimin e kostove operative duke qenë se humbjet komerciale reduktojnë të ardhurat dhe humbjet teknike rrisin kostot operative. Humbjet e ujit përbëhen nga dy komponentë, humbjet e dukshme, ku përfshihen humbjet nga menaxhimi jo i mirë i shoqërive (humbjet nga lidhjet e paligjshme, pasaktësia në matje në prodhim dhe tek konsumatorët), si dhe humbjet reale ose thënë ndryshe humbjet teknike që shkaktohen si pasojë e amortizimit të sistemeve (humbje të ujit në depo, rrjetin transmetues dhe shpërndarës, etj).

Gjatë vitit 2016, mesatarja e Ujit pa të Ardhura në sektor është 67,1 %. Krahësuar me vitin e kaluar, ku vlera e humbjeve ishte 66,7%, shohim tendencë në rritje të sasisë së ujit që humbet dhe një situatë jo të mirë të shoqërive UK. Vlera e lartë e këtij treguesi, situatë e cila nuk paraqet trend drejt përmirësimit ka qenë dhe mbetet shqetësim i vazhdueshëm për ERRU-në. Përzgjedhja e drejtuesve ligjor dhe teknik sipas kriterëve të vendosura, hartimi i planeve të biznesit dhe i planeve të veprimit do të ishin domosdoshmëri për një menaxhim më të mirë të shoqërive UK.

Grupi i I-ë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 2. Uji Pa të Ardhura për grupin e I-rë, viti 2016

Edhe për këtë vit, në grupin e parë të përbërë nga 11 shoqëri, situata paraqitet pothuaj e njëjtë me atë të vitit të kaluar. Puna për përmirësimin e këtij treguesi nuk ka qenë në nivele të mjaftueshme. Sh.a UK Korçë vazhdon të jetë me performancën më të mirë në këtë grup

megjithëse vlera e ujit pa të ardhura ka pësuar rritje me (+4,07%) si pasojë e zmadhimit të zonës se juridiksionit me disa njësi administrative të ish shoqërisë Sh.a U Korçë Fshat.

Ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në grupin e parë jepet si më poshtë në tabelën 6.

Tabela 6. Ecuria e Uji Pa të Ardhura për Grupin I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Shkodër	68.70	72.95	69.11	3.84
UK	Elbasan Qytet	80.65	75.93	73.95	1.98
UK	Vlorë	82.13	82.25	81.01	1.24
UK	Sarandë	72.87	78.01	77.20	0.81
UK	Durrës	72.87	71.90	71.59	0.31
UK	Fier	57.66	61.33	61.58	0.25
UK	Tiranë	68.38	66.81	67.77	0.96
U	Elbasan Fshat	36.15	33.65	35.06	1.41
UK	Korçë	25.18	25.94	30.01	4.07
UK	Berat - Kuçovë	74.55	76.30	83.47	7.17
UK	Kavajë	47.02	43.93	54.06	10.13

Në grupin e parë si rritja dhe ulja e nivelit të humbjeve për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 nuk e kalon 4%, me përjashtim të Sh.a UK Berat Kuçovë dhe Sh.a UK Kavajë ku rritja e humbjeve arrin deri në 10%. Për tre vitet e fundit shifrat tregojnë për një tendencë negative të këtij treguesi për Sh.a. UK Fier, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Kavajë, Sh.a UK Berat-Kuçovë, Sh.a UK Elbasan Fshat, Sh.a UK Tiranë dhe Sh.a UK Kavajë. Nivelet e larta të humbjeve të ujit për këto shoqëri por edhe për ato që niveli i humbjeve ka patur tendencë të ulët kërkojnë një menaxhim më të mirë të tyre. Ulja e humbjeve duhet të jetë prioritet i punës së tyre.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 3. Uji Pa të Ardhura për grupin e II-të, viti 2016

Në grupin e dytë të përbërë nga 25 shoqëri UK, vetëm dy prej tyre kanë këtë indikator nën kufirin 30% të Benchmarking Sh.a U Bilisht 20,94% dhe Sh.a UK Belsh 26,96% (Sh.a UK Himarë është përjashtuar nga vlerësimi për të dhëna të pabesueshme). Dhjetë shoqëri, treguesin e Ujit pa të Ardhura, e kanë nga 30-50% dhe 12 prej tyre performojnë me nivel të Ujit pa të Ardhura mbi 50% të këtij treguesi.

Shoqëritë në përgjithësi nuk janë korrekte në raportimin e të dhënave. Sasia e ujit të prodhuar të raportuar në Njësinë e Monitorimit e Benchmarking nuk përputhet me atë të raportuar për Bilancin e Ujit 2016 për pasojë vlerat e humbjeve të ujit nuk paraqiten të njëjta pranë dy institucioneve.

Më poshtë në tabelën 7, jepet ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në grupin e dytë.

Tabela 7. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
U	Gramsh	33.86	49.82	30.63	19.19
UK	Pogradec	53.84	46.66	30.91	15.75
U	Përmet	38.61	46.45	38.79	7.66
UK	Peshkopi	60.38	62.97	57.65	5.32
UK	Peqin	37.77	49.83	45.53	4.30
U	Bilisht	24.13	24.92	20.94	3.98
UK	Gjirokastrë	72.89	71.27	67.72	3.55
UK	Burrel	52.15	40.25	38.18	2.07
U	Kurbin	70.94	73.01	71.44	1.57
UK	Lushnjë	76.46	79.21	78.19	1.02
UK	Mallakastër	63.68	56.52	56.62	0.10
UK	Lezhë	48.46	46.50	47.64	1.14
UK	Patos	48.85	47.38	49.49	2.11
UK	Tepelenë	58.33	61.49	63.61	2.12
U	Ura Vajgurore	55.06	56.70	59.91	3.21
U	Shkodër Fshat	37.73	33.07	37.53	4.46
U	Korçë Fshat	30.59	33.66	38.29	4.63
UK	Krujë	63.17	57.08	62.29	5.21
U	Selenicë	80.20	78.30	90.99	12.69
UK	Librazhd	23.07	23.12	36.29	13.17
UK	Rrogozhinë	46.88	49.59	68.79	19.20
U	Lushnjë Fshat	35.69	28.25	53.35	25.10
UK	Kukës	20.14	13.15	52.79	39.64

Në këtë grup, niveli i humbjeve në vitin 2016 ka patur tendencë të ulët krahasuar me vitin 2015 për 10 shoqëri, ndërsa për 13 të tjera niveli i humbjeve është rritur, pra tendenca ka qenë negative. Për një menaxhim më të mirë të humbjeve të ujit spikasin Sh.a UK Pogradec dhe Sh.a U Gramsh. Për Sh.a UK Lushnje, Sh.a U Kurbin ulja e humbjeve si dhe për Sh.a UK Mallakastër e Sh.a UK Lezhë rritja e humbjeve është e papërfillshme.

Rritja më e madhe e nivelit të humbjeve është shënuar nga Sh.a UK Kukës me rreth 40%. Mungesa e matësve në prodhim dhe shpërndarje, pasaktësitë në matje, raportimet jo korrekte, menaxhimi jo i mirë etj kanë qenë disa nga arsyet që për tre vitet e fundit performanca e shoqërive Sh.a UK Librazhd, Sh.a UK Rrogozhinë, Sh.a UK Kukës, Sh.a U Lushnje Fshat, Sh.a U Selenicë, Sh.a U Korçë Fshat, Sh.a UK Peqin etj ka shënuar rënie.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 4. Uji Pa të Ardhura për grupin e III-të viti 2016

Në grupin e tretë të përbërë nga 21 shoqëri, gjendja paraqitet edhe më kritike, 15 shoqëri performojnë keq ku niveli i Ujit pa të Ardhura është mbi 50% të sasisë së ujit të prodhuar. Vetëm Sh.a U Gjirokastrë Fshat performon mirë (me nivel të humbjeve 12,62%).

Ecuria e treguesit Uji Pa të Ardhura për tre vitet e fundit në grupin e tretë jepet si më poshtë në tabelën 8.

Tabela 8. Ecuria e Ujit Pa të Ardhura për Grupin III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
U	Tropojë	82.26	71.71	61.86	9.85
U	Bulqizë	47.94	61.97	54.75	7.22
UK	Mirditë	74.82	66.14	60.02	6.12
U	Këlcyrë	84.32	83.66	77.57	6.09
UK	Fushë Arrëz	77.54	75.08	70.54	4.54
U	Has	54.50	56.10	52.28	3.82
U	Vau i Dejës	68.47	76.77	74.94	1.83
U	Gjirokastër Fshat	23.11	13.98	12.62	1.36
U	Divjakë	46.51	49.87	48.89	0.98
U	Poliçan	68.69	69.05	69.44	0.39
UK	Orikum	48.27	48.15	48.59	0.44
UK	Fushë Krujë	42.31	46.58	48.15	1.57
U	Novoselë	48.03	50.48	52.59	2.11
UK	Ersekë	59.94	47.46	51.46	4.00
UK	Pukë Fshat	69.68	69.74	74.63	4.89
U	Çorovodë	54.65	54.29	59.19	4.90
UK	Krastë	27.71	26.84	39.74	12.90
UK	Rubik	20.81	19.29	35.52	16.23
UK	Bashkia Pukë	59.50	60.19	77.02	16.83
U	Delvinë	31.59	24.11	62.87	38.76
UK	Libohovë	30.53	27.56	66.51	38.95

Në vitin 2016, përpjekje për përmirësimin e gjendjes, duke treguar një trend pozitiv për reduktimin e humbjeve, kanë bërë 9 shoqëri të këtij grupi. Ulja e humbjeve varion nga 1% deri 9.8%. Por për 12 shoqëri të këtij grupi përpjekjet për një menaxhim të mirë të humbjeve kanë munguar, niveli i humbjeve në vitin 2016 është rritur krahasuar me vitin 2015. Duke përjashtuar Sh.a U Poliçan dhe Sh.a UK Orikum, për të cilat rritja e nivelit të humbjeve është e papërfillshme, me pak se 1%, për shoqëritë e tjera rritja varion nga 2% deri në 39%. Për menaxhim jo të mirë të humbjeve mund të përmendim Sh.a U Libohovë dhe Sh.a UK Delvinë, të cilat kanë rritur humbjet e ujit në vlera të mëdha.

Nga analiza e të dhënave të raportuara për tre vitet e fundit, shohim se disa nga shoqëritë e këtij grupi paraqesin luhatje të mëdha të Ujit pa të Ardhura nga njëri vit në tjetrin si pasojë e një menaxhimi jo të qëndrueshëm. Këtë fenomen e shohim në shoqëritë Sh.a UK Ersekë, Sh.a UK Delvinë, Sh.a U Libohovë, Sh.a UK Krastë, Sh.a U Bulqizë dhe Sh.a UK Rubik.

Përfundime

Për vitin 2016, niveli i Ujit pa të Ardhura është 67,1%, krahasuar me vitin e kaluar ku treguesi i ujit pa të ardhura kishte trend në rënie, për këtë vit sasia e ujit që nuk gjeneron të ardhura paraqet tendencë në rritje megjithëse në vlerë të vogël me 0,1%. Performojnë mirë në sektor, me nivel të Ujit pa të Ardhura rreth 30%, vetëm 6 shoqëri UK, 15 shoqëri kanë performancë të dobët dhe numri i shoqërive që performojnë keq ka pësuar rritje nga 30 në 36 shoqëri.

Sikurse shihet, analiza e performancës tregoi që niveli i Ujit pa të Ardhura me tendencë në ngritje për këtë vit, do të rëndojë akoma më shumë qëndrueshmërinë financiare në shumicën e shoqërive. Angazhimi për marrjen e masave të duhura dhe hartimi i planeve të veprimit për të reduktuar shpenzimet e panevojshme që lindin nga mbiprodhimi si dhe menaxhimi i mire i humbjeve komerciale (dukshme) dhe atyre teknike (reale) është emergjente për shumicën e shoqërive UK. Reduktimi i lidhjeve të paligjshme, evidentimi i klientëve të rinj, rritja e faturimit dhe arkëtimit, vendosja e matësve në prodhim dhe shpërndarje do të përmirësonte situatën financiare të shoqërisë.

Si përfundim, Enti Rregullator i Ujit i sugjeron të gjitha shoqërive UK që nëpërmjet "Bilancit të Ujit", i cili deri tani nuk hartohet saktë nga shumë shoqëri ose neglizhohet prej tyre, të vlerësojnë situatën aktuale dhe të hartojnë planet e veprimit për të realizuar reduktimin e Ujit pa të Ardhura që edhe për këtë vit është akoma më larg kufirit strategjik të vendosur.

ERRU është e gatshme të mbështesë të gjitha shoqëritë UK në punën e tyre nëpërmjet instrumenteve dhe strategjive rregulluese që ajo harton për sektorin UK.

2.4.2 Mbulimi i Kostove O&M

“Mbulimi i kostove O&M” është treguesi që pasqyron se deri në çfarë mase shoqëria mbulon me të ardhurat e realizuara nga aktiviteti kostot e drejtpërdrejta që i nevojiten për funksionimin e sistemit dhe mirëmbajtjen e tij. (pa kostot kapitale dhe të amortizimit). Ky është një nga treguesit kryesorë që bën të mundur vlerësimin e situatës financiare të një shoqërie.

Në vitin 2016, niveli mesatar i këtij treguesi për gjithë sektorin UK është 118% nga 102% që ishte në vitin paraardhës. Sektori në këtë tregues ka pësuar një rritje të ndjeshme e cila është rrjedhojë e uljes së kostove dhe rritjes së të ardhurave. Ky tregues ka arritur objektivin e strategjisë së sektorit dhe performancës së mirë të ERRU që në vitin 2013, pasi kostot e operimit dhe mirëmbajtjes duke filluar nga ky vit janë mbuluar mbi 100%.

* Në vijim për shoqëritë me këtë shënim është bërë përlogaritja e mbulimit të kostove O&M sipas balanceve financiare të dorëzuara nga shoqëritë UK pranë ERRU për vitin 2016 dhe jo nga të dhënat e marra nga AKUK, për shkak të luhatjeve të mëdha sa i përket të dhënave të cilat janë deklaruar gabim.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 5. Mbulimi i kostove O&M për grupin e I-rë, viti 2016.

Në grupin e parë, bëjnë pjesë shoqëritë më të mëdha, pjesa më e madhe e të cilave për disa vite rresht arrijnë të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes mbi 100%.

Niveli i objektivit të synuar për performancë të mirë 100% i vendosur nga ERRU është tejkaluar nga 7 shoqëri, Sh.a UK Tiranë*, Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Berat-Kuçovë*, Sh.a UK Elbasan*, Sh.a UK Fier, Sh.a UK Sarandë dhe Sh.a UK Shkodër.

Në tabelën 9, si më poshtë paraqitet ecuria e treguesit mbulimi i Kostove O&M për tre vitet e fundit.

Tabela 9. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Elbasan Qytet	135.00	97.00	134.00	37.00
UK	Durrës	91.00	66.48	88.44	21.96
UK	Tiranë	187.00	151.00	157.00	6.00
U	Elbasan Fshat	61.00	56.92	62.85	5.93
UK	Fier	129.00	121.61	126.85	5.24
UK	Shkodër	124.00	108.06	104.31	3.75
UK	Kavajë	98.00	67.00	63.00	4.00
UK	Berat - Kuçovë	145.00	139.00	127.00	12.00
UK	Vlorë	103.00	88.34	75.27	13.07
UK	Sarandë	138.00	132.53	118.65	13.88
UK	Korçë	178.00	194.28	157.00	37.28

Krahasuar më vitin 2015 në këtë grup pesë shoqëri kanë pasur përmirësim në mbulimin e kostos së operimit dhe mirëmbajtjes për vitin 2016 duke rritur shkallën e mbulimit të kostove O&M nga 5.24% deri në 37%. Edhe pse për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 Sh.a UK Elbasan Qytet dhe Sh.a UK Durrës kanë përmirësimin më të madh respektivisht me (+37%) dhe (+21.96%) ato mbeten në nivele më të ulëta se në vitin 2014 ku kanë pasur një regres të ndjeshëm.

Gjithashtu Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Berat Kuçovë dhe Sh.a UK Shkodër që të paktën për tre vitet e fundit i mbulojnë kostot O&M mbi 100% dhe bëjnë pjesë në shoqëritë me performancë të mirë, për vitin 2016 kanë pësuar një rënie të këtij treguesi. Tendencën më të madhe negative e ka shënuar Sh.a UK Korçë me (-37.28%).

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 6. Mbulimi i kostove O&M për grupin e II-të, viti 2016.

Ky grup në vitin 2016, përbëhet nga 25 shoqëri. Edhe në këtë grup evidentohen 7 shoqëri që kanë arritur të mbulojnë kostot e operimit dhe mirëmbajtjes me mbi 100% dhe renditen si shoqëri me performancë të mirë. Shoqëria me mbulim më të mirë të kostove O&M është Sh.a UK Gjirokastrë me 135% dhe me një përmirësim (+11%) krahasuar me vitin paraardhës, e ndjekur nga Sh.a UK Burrel* me 127%. Rezultatet e këtyre shoqërive bazohen në të dhënat e balanceve financiar për vitin 2016, pasi në të dhënat e raportuara në Njësinë e Monitorimit ka informacion shumë kontradiktor, gjë që devijon edhe nivelin e këtij treguesi.

Edhe njëherë theksojmë se saktësia dhe besueshmëria e të dhënave luan një rol të rëndësishëm në vlerësimin e performancës. Në zonën e performancës së dobët renditen pjesa më e madhe e shoqërive, 12 shoqëri.

Në brezin e performancës së pranueshme, mbi 80%, janë renditur gjashtë shoqëri. Për Sh.a U Ura Vajguore dhe Sh.a.UK Tepelenë rritja e shkallës së mbulimit të kostove O&M për vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 ka bërë që këto shoqëri të kalojnë nga performanca e dobët në atë të pranueshme. Ecuria e këtij treguesi për grupin e dytë gjatë tre viteve të fundit paraqitet si më poshtë në tabelën 10.

Tabela 10. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për Grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Tepelenë	52.00	53.01	85.54	32.53
U	Ura Vajguore	77.00	56.00	82.00	26.00
UK	Librazhd	101.00	100.00	118.00	18.00
U	Korçë Fshat	43.00	52.14	67.93	15.79
UK	Gjirokastër	119.00	124.00	135.00	11.00
UK	Lushnjë	106.00	90.00	99.00	9.00
UK	Lezhë	127.00	117.66	124.54	6.88
UK	Burrel	120.00	121.00	127.00	6.00
U	Selenicë	39.00	38.80	42.60	3.80
UK	Peshkopi	132.00	114.76	116.86	2.10
U	Kurbin	52.00	41.28	43.21	1.93
U	Patos	23.00	17.91	18.42	0.51
U	Përmet	86.00	75.51	75.11	0.40
U	Bilisht	107.00	95.00	93.00	2.00
U	Lushnjë Fshat	66.00	69.38	67.32	2.06
UK	Kukës	77.00	102.00	97.00	5.00
U	Gramsh	112.00	110.00	104.00	6.00
U	Shkodër Fshat	73.00	50.78	41.38	9.40
UK	Krujë	104.00	108.62	98.33	10.29
UK	Peqin	76.00	64.02	49.72	14.30
UK	Pogradec	134.00	127.00	110.00	17.00
UK	Mallakastër	48.00	65.61	47.34	18.27
UK	Rrogozhinë	51.00	71.00	51.00	20.00

Nga 25 shoqëri të këtij grupi, 9 shoqëri e kanë përmirësuar treguesin e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015. Përmirësimi në mbulimin e kostove të operimit dhe mirëmbajtjes varion nga 0.51% deri në 32.53%. Sh.a UK Pogradec* dhe Sh.a UK Gramsh edhe pse renditen në shoqëritë me performancë të mirë në mbulimin e kostove, këtë vit mbulimi i kostove O&M ka patur tendencë negative.

Tendenca negative e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes është regjistruar për 12 shoqëri të këtij grupi. Ulja e nivelit të mbulimit të këtyre kostove varion nga 0,40% deri në 20%. Për disa shoqëri si Sh.a U Patos, Sh.a U Kurbin, Sh.a U Shkodër Fshat, Sh.a UK Peqin Sh.a UK Mallakastër, të cilat kanë nivel të ulët në mbulimin e kostove O&M, tendenca negative e mbulimit të kostove e ka përkeqësuar akoma më shumë atë.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 7. Mbulimi i kostove O&M për grupin e III-të, viti 2016

Objektivi i vendosur nga ERRU për performancë të mirë, për të mbuluar tërësisht kostot O&M është arritur nga 3 shoqëri, Sh.a UK Ersekë* me 117% dhe Sh.a UK Tropojë me 105.16%, dhe UK Bashkia Pukë* me 103%.

Në zonën e performancës së pranueshme për vitin 2016 nuk gjendet asnjë shoqëri e këtij grupi. Nga 21 shoqëritë e marra në analizë në këtë grup, 18 prej tyre renditen nën vijën e kuqe, pra në brezin e performancës së dobët.

Shoqëria me performancën më të dobët është Sh.a U Pukë Fshat, që mbulon vetëm 25.77% të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes.

Ecuria e treguesit mbulimi i kostove të operimit dhe mirëmbajtjes për grupin e tretë gjatë tre viteve të fundit paraqitet si më poshtë në tabelën 11:

Tabela 11. Ecuria e mbulimit të kostove O&M për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Ersekë	140.00	84.00	117.00	33.00
U	Has	47.00	41.51	59.04	17.53
UK	Mirditë	57.00	56.75	69.75	13.00
U	Tropojë	130.00	92.18	105.16	12.98
UK	Orikum	42.00	35.07	47.20	12.13
U	Çorovodë	40.00	35.70	45.48	9.78
UK	Fushë Arrëz	58.00	47.08	56.11	9.03
UK	Libohovë	48.00	41.53	46.66	5.13
UK	Bashkia Pukë	88.00	100.00	103.00	3.00
U	Poliçan	41.00	32.75	34.57	1.82
U	Këlcyrë	59.00	58.03	59.77	1.74
U	Gjirokastër Fshat	27.00	32.09	33.64	1.55
U	Vau i Dejës	44.00	26.30	26.80	0.50
U	Bulqizë	103.00	81.00	79.00	2.00
U	Pukë Fshat	28.00	28.10	25.77	2.33
UK	Fushë Krujë	69.00	49.43	46.70	2.73
U	Divjakë	66.00	51.00	47.28	3.72
U	Novoselë	55.00	44.06	36.88	7.18
UK	Krastë	57.00	82.68	68.49	14.19
UK	Rubik	82.00	87.44	57.16	30.28
UK	Delvinë	93.00	83.61	41.00	42.61

Për shoqëritë e grupit të tretë, mbulimi i kostove O&M në vitin 2016 ka patur tendencë pozitive krahasuar me vitin 2015 për pjesën më të madhe të shoqërive, por megjithatë nivelet e mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes mbeten të ulëta. Rritja e shkallës së mbulimit të kostove të operimit dhe mirëmbajtjes në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 varion nga 0.50% në 33%.

Për tetë shoqëri tendenca e mbulimit të kostove O&M është negative. Ulja varion nga 2% deri në 42.61%. Për tre shoqëri, Sh.a U Delvinë, Sh.a UK Fushë Arrëz dhe Sh.a UK Krastë ulja e shkallës së mbulimit të kostove në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 është e konsiderueshme dhe ka bërë që këto shoqëri të kalojnë në brezin e performancës së dobët. Ndërsa për Sh.a U Bulqizë, Sh.a U Pukë Fshat, Sh.a U Divjakë dhe Sh.a UK Fushë Krujë megjithëse ulja e shkallës së mbulimit të kostove O&M nuk është më shumë se 4%, shqetësues është fakti që të paktën në tre vitet e fundit tendenca është negative.

Përfundime

Nga analiza e këtij treguesi për të tre grupet e shoqërive rezulton se megjithëse niveli i mbulimit të kostove O&M për sektorin është përmirësuar krahasuar me vitin 2015 nga 102% në 118%. Ky përmirësim i situatës ka ardhur kryesisht si rezultat i rritjes së të ardhurave nga aktiviteti UK në sektor me rreth 14% pasi ulja e kostove O&M është vetëm 0.5%. Megjithatë, jo të gjitha shoqëritë UK kanë rezultat pozitiv në përmirësimin e këtij treguesi. Nga 57 shoqëri, 18 prej tyre

kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të kostove O&M, 7 shoqëri janë në nivelin e mbulimit 80%-100% dhe 33 shoqëri janë në nivelin nën 80%. Në sektor operojnë 18 shoqëri të cilat nuk mbulojnë as 50% të kostove O&M. Këto shoqëri nuk kanë aftësi financiare për të përballuar kostot dhe vazhdimësia e aktivitetit të tyre mbështetet nga subvencionimi i buxhetit të shtetit.

Një rol të rëndësishëm në mbulimin e kostove luan vendosja e një raporti sa më të mirë ndërmjet shpenzimeve dhe të ardhurave, prandaj është e rëndësishme që shoqëritë UK të punojnë si për të rritur të ardhurat dhe për të ulur kostot e shërbimeve. Operatorët duhet të marrin në konsideratë të gjitha opsionet për të rritur efikasitetin operacionale, faturimin dhe arkëtimin e të ardhurave si dhe kontrollin e kostove. Për të identifikuar pikat e nisjes për një efikasitet më të mirë, është e nevojshme të analizohen në veçanti treguesit si: Uji pa të Ardhura, Niveli i Matjes, Efikasiteti e Stafit dhe Efikasiteti e Energjisë. Ulja e nivelit të humbjeve, reduktimi i stafit të tepërt dhe rritja e efikasitetit në punë do të thotë ulje e shpenzimeve jo efektive. Nga ana tjetër rritja e nivelit të faturimit dhe arkëtimin luajnë një rol të rëndësishëm për përmirësimin e mbulimit të kostove O&M.

ERRU vazhdon ta konsiderojë mbulimin tërësor të kostove O&M nga shoqëritë, si një hap i parë drejt mbulimit të plotë të kostove në të ardhmen. Ndryshimi i tarifave luan një rol të rëndësishëm në nivelin e të ardhurave të shoqërisë dhe për rrjedhojë edhe në mbulimin e kostove. Vendosja e tarifave sa më të drejta kërkon vlerësimin e kostove për çdo shërbim të kryer. Për ERRU ndarja e shpenzimeve sipas qendrave të kostos merr një rëndësi të veçantë në kushtet kur krahas tarifave për shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizimeve duhet të miratojë për disa shoqëri edhe tarifën për shërbimin e trajtimit të ujërave të ndotura. ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka theksuar se përmirësimi i situatës financiare të shoqërive UK duhet të vijë jo vetëm nga rritja e tarifave por edhe nga një menaxhim i mirë i burimeve teknike e financiare.

2.4.3 Mbulimi i Kostove Totale

Objektivi i çdo shoqërie është mbulimi i Kostos Totale me të ardhurat e realizuara nga veprimtaria kryesore dhe nga shërbimet e tjera. Për vitin 2016, niveli mesatar i këtij treguesi për sektorin është 89.9%. Ky tregues gjatë tre viteve të fundit ka patur luhatje negative dhe pozitive. Krahasuar me vitin 2015, niveli i mbulimit të Kostos Totale për vitin 2016 për sektorin është rritur me 11%. Niveli i arritur i këtij treguesi dhe tendenca e tij tregojnë se sektori ujësjellës kanalizime është duke performuar mirë. Në vitin 2016, objektivi strategjik (78%) dhe ai i performancës së mirë të ERRU (80%) i këtij treguesi për sektorin është tejkaluar, që tregon një zhvillim edhe më pozitiv.

* Në vijim për shoqëritë me këtë shënim është bërë përlogaritja e kostos totale sipas bilanceve financiare të dorëzuara nga shoqëritë UK pranë ERRU për vitin 2016 dhe jo nga të dhënat e marra nga AKUK, për shkak të luhatjeve të mëdha sa i përket të dhënave të cilat janë deklaruar gabim.

Grupi i I-ë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 8. Mbulimi i kostove Totale për Grupin e I-rë, Viti 2016

Në grupin e parë janë 6 shoqëri të cilat janë në nivelin e performancës së mirë mbi 80% nga të cilat Sh.a UK Tiranë* dhe Sh.a UK Fier i mbulojnë kostot totale respektivisht 138% dhe 102.72%. Është për tu theksuar se në grupin e parë vetëm Sh.a UK Kavajë është operatori që performon më dobët dhe mbulon kostot totale në masën 39%.

Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e parë sipas tre viteve të fundit paraqitet në tabelën 12 si më poshtë.

Tabela 12. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Durrës	65.00	55.78	76.15	20.37
UK	Tiranë	123.00	121.00	138.00	17.00
UK	Elbasan Qytet	105.00	76.00	88.00	12.00
UK	Korçë	95.00	86.72	98.60	11.88
UK	Fier	94.00	92.76	102.72	9.96
U	Elbasan Fshat	57.00	48.54	53.88	5.34
UK	Sarandë	82.00	86.00	88.00	2.00
UK	Shkodër	106.00	76.85	78.65	1.80
UK	Berat – Kuçovë	103.00	104.00	98.00*	6.00
UK	Kavajë	58.00	45.33	39.01	6.32
UK	Vlorë	65.00	63.31	51.85	11.46

Ecurinë më të mirë krahasuar me vitin paraardhës e ka Sh.a UK Durrës, mbulimi i Kostos Totale është rritur me 20.37%, e cila përfaqëson edhe rritjen më të madhe në këtë grup. Shkalla e mbulimit të kostos është rritur edhe për shtatë shoqëritë e tjera të cilat janë renditur pas kësaj shoqërie. Niveli më i ulët i rritjes është 1.80 % i regjistruar nga Sh.a UK Shkodër.

Vlen për tu theksuar se vetëm për Sh.a UK Sarandë për tre vite rresht mbulimi i Kostos Totale ka patur trend pozitiv. Për shoqëritë e tjera të këtij grupi ky tregues ka patur luhatje negative dhe pozitive nga një vit në tjetrin. Rënie të këtij treguesi në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 kanë pasur tre shoqëri, Sh.a.UK Berat-Kuçovë, Sh.a UK Vlorë si dhe Sh.a UK Kavajë. Për këto dy të fundit mbulimi i Kostos Totale ka patur tendencë negative edhe një vit më parë, gjë e cila ka bërë që mbulimi i Kostos Totale në dy vjet të ulët me rreth 18 % për Sh.a UK Kavajë dhe 13% për Sh.a UK Vlorë.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 9. Mbulimi i kostove Totale për grupin e II-të, viti 2016

Në grupin e dytë, objektivi i ERRU për performancë të mirë është tejkaluar nga 7 prej 25 shoqërive të këtij grupi, 4 prej të cilave Sh.a U Peshkopi, Sh.a UK Gjirokastër qytet, Sh.a UK Burrel dhe Sh.a UK Librazhd kanë arritur të mbulojnë mbi 100% të Kostos Totale. Në brezin e performancës së pranueshme janë 10 shoqëri të cilat duken qartë dhe nga grafiku dhe konkretisht janë shoqëritë nga Sh.a UK Kukës deri tek Sh.a UK Ura Vajgurore. Edhe Sha UK Belsh si një shoqëri e re i përket këtij brezi performues.

Në brezin e performancës së dobët pra në nivelin nën 50% janë 8 shoqëri, sipas grafikut nga Sh.a U Patos deri tek Sh.a U Rrogozhinë.

Më poshtë në tabelën 13 paraqitet ecuria sa i përket treguesit të mbulimit të kostove Totale për grupin e dytë.

Tabela 13. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Lezhë	91.00	70.24	95.52	25.28
U	Korçë Fshat	37.00	42.19	57.69	15.50
UK	Peshkopi	98.00	91.62	106.50	14.88
UK	Krujë	47.00	44.49	56.52	12.03
UK	Tepelenë	42.00	42.73	54.47	11.74
UK	Rrogozhinë	38.00	36.62	47.20	10.58
UK	Lushnjë	74.00	62.00	65.00	3.00
U	Selenicë	26.00	26.82	28.94	2.12
U	Përmet	73.00	67.92	69.12	1.20
UK	Librazhd	85.00	99.00	100.00	1.00
U	Patos	22.00	17.08	17.39	0.31
U	Kurbin	48.00	39.05	39.05	0.00
UK	Kukës	54.00	71.00	71.00	0.00
U	Bilisht	100.00	94.00	92.00	2.00
UK	Pogradec	70.00	56.00	54.00	2.00
U	Lushnjë Fshat	42.00	47.75	45.43	2.32
U	Gramsh	88.00	87.00	84.00	3.00
U	Shkodër Fshat	42.00	36.29	31.99	4.30
UK	Gjirokastër	112.00	112.00	104.00	8.00
UK	Peqin	67.00	59.45	46.69	12.76
U	Ura Vajgurore	65.00	66.41	51.96	14.45
UK	Mallakastër	41.00	60.80	44.47	16.33
UK	Burrel	100.00	120.00	102.00	18.00

Duke krahasuar vitin 2016 me vitin 2015 sipas tabelës së mësipërme duket qartë që tendencën pozitive më të mirë e ka patur Sh.a UK Lezhë me (+25.28%) e cila ka rikuperuar rënien që ka patur gjatë vitit 2015 me (-21%). Më pas renditen dhe shtatë shoqëri të tjera të cilat kanë përmirësime të ndjeshme. Gjithashtu është për tu veçuar Sh.a UK Korçë fshat i cili është i vetmi operator në këtë grup që ka patur për disa vite rresht tendencë pozitive. Pesë shoqëri të këtij grupi duke filluar nga Sh.a U Përmet deri tek Sh.a UK Kukës kanë mbajtur të njëjtin nivel të mbulimit të kostove me luhatje të vogla pozitive por të pandjeshme në rezultatin financiar të këtyre shoqërive.

Në grupin e dytë janë 10 shoqëri që kanë shënuar rënie të këtij treguesi e cila varion nga -18% në -2%. Rënien më të madhe e ka Sh.a UK Burrel dhe Sh.a UK Gjirokastër Qytet, shoqëri të cilat janë në brezin e performancës shumë të mirë pasi i mbulojnë kostot totale mbi 100%. Rënia me mbi 10% e mbulimit të Kostos Totale në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 për shoqëritë UK Mallakastër, U Ura Vajgurore si dhe UK Peqin, ka bërë që këto shoqëri të mbulojnë më pak së 50% të kostos totale të shërbimeve që ato kryejnë.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 10. Mbulimi i kostove Totale për grupin e III-të, viti 2016

Në grupin e tretë janë 21 shoqëri të marra në analizë lidhur me nivelin e mbulimit të kostove totale për vitin 2016.

Në nivelin e performancës së mirë janë vetëm dy shoqëri dhe konkretisht Sh.a UK Ersekë dhe UK Bashkia Pukë respektivisht me 107% dhe 82%. Në nivelin e performancës së pranueshme (50% deri 80%) janë Sh.a U Tropojë (78.93%) dhe Sh.a U Këlcyrë me (54.78%).

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi, 17 prej tyre, bëjnë pjesë në brezin e performancës së dobët, pasi nuk kanë arritur të mbulojnë as 50% të kostos totale. Sh.a U Pukë fshat dhe Sh.a U Vau Dejës janë shoqëritë me nivelin më të ulët të mbulimit të kostos totale me respektivisht 17.85% dhe 25.19%.

Në tabelën 14 si më poshtë paraqitet ecuria e shoqërive të këtij treguesi sipas tre viteve të fundit për grupin e tretë.

Tabela 14. Ecuria e mbulimit të kostove Totale për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Ersekë	113.00	78.00	107.00	29.00
U	Tropojë	102.00	63.33	78.93	15.60
UK	Orikum	40.00	31.71	45.05	13.34
U	Has	38.00	34.40	44.29	9.89
UK	Fushë Krujë	46.00	34.24	43.93	9.69
U	Çorovodë	28.00	29.04	36.38	7.34
UK	Libohovë	40.00	35.68	40.72	5.04
UK	Krastë	37.00	41.58	46.23	4.65
UK	Fushë Arrëz	46.00	37.69	41.77	4.08
UK	Bashkia Pukë	69.00	79.00	82.00	3.00
U	Bulqizë	89.00	75.00	77.94	2.94
U	Polican	35.00	29.66	31.44	1.78
U	Gjirokastër Fshat	20.00	27.37	28.76	1.39
U	Këlcyrë	57.00	54.22	54.78	0.56
U	Vau i Dejës	43.00	24.88	25.19	0.31
U	Divjakë	52.00	45.81	43.52	2.29
U	Pukë Fshat	20.00	20.60	17.85	2.75
U	Novoselë	43.00	35.88	32.16	3.72
UK	Mirditë	51.00	52.35	33.91	18.44
UK	Rubik	77.00	56.59	37.85	18.74
UK	Delvinë	83.00	75.10	38.00	37.10

Pjesa më e madhe e shoqërive të këtij grupi në vitin 2016 kanë përmirësuar shkallën e mbulimit të Kostove Totale ndonëse disa prej tyre në nivele të papërfillshme. Rritja varion nga 0.3 % deri në 29%. Krahasuar me vitin 2015 ecurinë më të mirë gjatë vitit 2016 e ka patur Sh.a UK Ersekë e cila ka shënuar nivelin më të lartë të rritjes. Në nivelin e përmirësimit nga 3% deri në 10% të mbulimit të Kostove Totale janë 7 shoqëri duke filluar nga Sh.a U Has deri tek UK Bashkia Pukë, ndërsa në nivele minimale përmirësimi janë dhe pesë shoqëri të tjera. Edhe pse në këtë grup performanca është e dobët përse i përket mbulimit të Kostove Totale, shoqëritë bëjnë përpjekje për tu përmirësuar, por duke qenë se nivelet e mbulimit janë të ulëta përmirësimi nuk e ndryshon situatën e dobët financiare të tyre.

Regresi më i madh në mbulimin e Kostos Totale është regjistruar nga Sh.a UK Delvinë. Ulja e nivelit të mbulimit të Kostos Totale në vitin 2016 në 38% nga 75.1% që ishte në vitin 2015 ka bërë që kjo shoqëri nga niveli i performancës së pranueshme ku ka qenë një vit më parë të kalojë në nivelin e performancës së dobët. Edhe për Sha UK Rubik dhe Sh.a UK Mirditë ulja e shkallës së mbulimit të koston totale është e ndjeshme, mbi 18% dhe ka përkeqësuar kështu akoma më shumë këtë tregues. Nëse një vit më parë këto shoqëri mbulonin të paktën gjysmën e kostove totale të shërbimeve që kryejnë në vitin 2016 ato mezi arrijnë të mbulojnë një të tretën e tyre.

Përfundime

Në vitin 2016, niveli i mbulimit të Kostos Totale është rritur nga 79% që ishte një vit më parë në 89.8%. Në sektor numërohen 15 shoqëri që mbulojnë Kostot Totale me mbi 80% dhe nga këto 7 shoqëri i mbulojnë ato mbi 100%, ndërsa një vit më parë vetëm 4 shoqëri mbulonin 100% Kostot Totale. Në pamje të parë duket se performanca e shoqërive përsa i përket mbulimit të Kostove Totale për shërbimet e ofruara është përmirësuar, por nga analiza e performancës së shoqërive UK sipas grupeve rezulton se shumë shoqëri të grupit të dytë dhe veçanërisht ato të grupit të tretë, janë shumë larg përballimit të këtyre kostove pa ndihmën e subvencioneve. Në sektor numërohen 25 shoqëri që mbulojnë Kostot Totale deri 50%.

Niveli i këtij treguesi për sektorin është i ndikuar nga rezultatet e shoqërive të grupit të parë. Ky konkluzion bëhet edhe më i qartë nëse i referohemi të dhënave të tabelës 15 të mëposhtme, ku treguesi i mbulimit të Kostove Totale është përllogaritur sipas të ardhurave dhe kostove për çdo grup.

Tabela 15. Mbulimit i Kostove Totale sipas të ardhurave dhe kostove për çdo grup

Emërtimi	Numri i shoqërive	Të ardhurat nga aktiviteti (000/lek)	Kostot Totale (000/lek)	Niveli i treguesit	Pesha specifike e të ardhurave	Pesha specifike e kostove
Grupi i parë	11	6,270,184	6,037,709	104%	82.60%	70.60%
Grupi i dytë	25	1,106,999	2,029,887	55%	14.60%	23.80%
Grupi i tretë	21	218,591	479,081	46%	2.80%	5.60%
Totali	57	7,595,774	8,546,677	89%	100%	100%

Analiza e të dhënave të tabelës së mësipërme tregon se rezultati pozitiv në mbulimin e Kostove Totale është arritur vetëm nga 11 shoqëritë e grupit të parë, Kostot Totale të të cilave zënë 70% të kostos të shërbimeve UK në sektor dhe të ardhurat e realizuara prej tyre zënë 82.6% të të ardhurave në sektor. Për grupin e dytë dhe i tretë ku bëjnë pjesë 46 shoqëri niveli i mbulimit të Kostove Totale është shumë i ulët respektivisht 55% dhe 46%. Megjithatë numri i shoqërive është shumë i madh, pesha specifike e të ardhurave dhe kostove është shumë më e vogël se ajo e grupit të parë.

Tabela 16. Ecuria e zërave kryesorë të shpenzime dhe të ardhurave për tre vitet rresht

Zërat e kostos	Njësia	2014	2015	2016
Kostot e punës	000/lek	2,558,318	2,840,900	3,022,654
Energjia	000/lek	1,861,948	2,419,476	2,319,502
Amortizimet	000/lek	1,518,904	1,496,879	1,643,882
Riparim dhe mirëmbajtje	000/lek	406,313	607,931	447,019
Materiale e kimikate	000/lek	250,210	214,895	186,548
Shpenzime financiare	000/lek	468,014	450,109	162,658
Të tjera	000/lek	154,574	227,631	251,242
Shërbimet e kontraktuale	000/lek	248,064	337,162	359,655
Provizjonet	000/lek	236,792	223,917	114,119
TOTALI I KOSTOVE UK	000/lek	7,703,136	8,818,898	8,865,723
KOSTOT Operim & Mirëmbajtjes	000/lek	5,479,426	6,647,993	6,611,119

Për vitin 2016, kosto e operimit dhe mirëmbajtjes për sektorin UK janë rritur me 46 mijë lekë dhe ato totale janë ulur me 37 mijë lekë, krahasuar me vitin 2015. Analiza e zërave të veçantë të kostos tregon se rritjet e nivelit të kostove për zërat paga, shërbime të kontraktuara, shpenzime të tjera, amortizim janë kompensuar nga ulja e shpenzime për energjinë elektrike, riparim e mirëmbajtje, provigjonet, shpenzimet për materiale e kimikate.

Të ardhurat nga aktiviteti dhe të ardhurat e tjera UK për vitin 2016 janë rritur me rreth 276 milion lekë ose 4% krahasuar me vitin 2015.

Për shoqëritë UK burimi kryesor i të ardhurave janë të ardhurat nga aktiviteti kryesor, por krahas tyre ato realizojnë edhe të ardhura të tjera që vijnë nga burime të tjera siç janë subvencionet e shfrytëzimit dhe të ardhurat financiare. Në totalin e të ardhurave të ardhurat nga aktiviteti UK zënë 94%, të ardhurat financiare 1% dhe të ardhurat nga subvencionet 5%.

Sipas informacionit të Njesisë së Monitorimit subvencionet për këtë vit janë rreth 421 milion lekë. Nga viti në vit subvencionet e shfrytëzimit kanë patur ulje. Krahasuar me pesë vite më parë shuma e subvencionuar në vitin 2016 është 6 herë më pak.

Prandaj faturimi i shërbimeve për të gjithë klientët në zonën e shërbimit dhe mbledhja e të ardhurave është një nga drejtimet kryesore të punës së shoqërive. Nga ana tjetër edhe përmirësimi i treguesve si Uji pa të Ardhura dhe Eficienca e Stafit, do të sjellin ulje të kostove në dy zëra që zënë pjesën më të madhe të shpenzimeve operative të shoqërive, kostot e energjisë elektrike dhe kostot e punës. Prandaj shoqëritë UK duhet të punojnë më shumë në përmirësimin e treguesve të punës.

2.4.4 Norma e Arkëtimit

Norma e Arkëtimit është shprehja në përqindje e shumës së arkëtuar ndaj shumës së faturuar për shërbimet e ofruara ujësjellës-kanalizime. Ky tregues na lejon të kuptojmë se sa efektive është një shoqëri për të garantuar likuiditetin e saj. Në thelb, performanca e mirë në lidhje me normën e arkëtimit është funksion menaxherial.

Për vitin 2016, norma mesatare e arkëtimit në sektorin ujësjellës-kanalizime është 91.5% nga 92% që ishte në vitin paraardhës. Ky tregues për disa vite rresht ka patur trend pozitiv, por është ende larg nivelit të objektivit të përcaktuar në Strategjinë Sektoriale të Shërbimit UK e cila për vitin 2016 është 96%.

* Në vijim për shoqëritë me këtë shënim është bërë përlogaritja e normës së arkëtimit sipas bilanceve financiare të dorëzuara nga shoqëritë UK pranë ERRU për vitin 2016 dhe jo nga të dhënat e marra nga AKUK, për shkak të luhatjeve të mëdha sa i përket të dhënave të cilat janë deklaruar gabim.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 11. Norma e Arkëtimit për grupin e I-rë, Viti 2016

Në grupin e parë, shoqëritë me performancën më të mirë me 100% të këtij treguesi për vitin 2016 janë Sh.a. UK Tiranë, Sh.a U Elbasan Fshat dhe Sh.a UK Elbasan*. Niveli mbi 100% tregon se këto shoqëri kanë punuar fort për të mbledhur edhe detyrimet e prapambetura. Niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të mirë në mbledhjen e të ardhurave është arritur dhe tejkaluar nga Sh.a UK Korçë* me 95%, Sh.a UK Fier 90.69% si dhe Sh.a UK Berat Kuçovë 85.92%. Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë shoqëritë Sh.a UK Kavajë, Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Durrës, Sh.a UK Vlorë dhe Sh.a UK Shkodër. Më poshtë në Tabelën 17 paraqitet ecuria e treguesit Norma e Arkëtimit për grupin e parë.

Tabela 17. Ecuria e Normës së Arkëtimit për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Elbasan Qytet	93.37	82.49	100.00	17.51
UK	Fier	74.74	76.55	90.69	14.14
UK	Kavajë	80.47	71.35	79.02	7.67
UK	Tiranë	111.09	107.34	112.80	5.46
UK	Korçë	92.99	95.02	95.00	0.02
UK	Durrës	68.03	76.89	76.60	0.29
UK	Berat - Kuçovë	84.48	89.46	85.92	3.54
U	Elbasan Fshat	102.39	107.85	103.14	4.71
UK	Sarandë	73.62	83.10	76.60	6.50
UK	Vlorë	71.05	77.91	66.19	11.72
UK	Shkodër	67.90	79.89	62.51	17.38

Në grupin e parë përmirësimi në mbledhjen e të ardhurave krahasuar me një vit më parë varion nga 5.46% deri në 17.51%. Nga 11 shoqëri katër prej tyre kanë shënuar progres ndërsa pjesa tjetër e shoqërive nuk ka mundur të arketojë më shumë të ardhura se në vitin 2015, duke ulur kështu nivelin e arkëtimit. Kjo gjë tregon se këto shoqëri nuk kanë punuar sa duhet dhe nuk kanë treguar të njëjtën vëmendje si një vit më parë në drejtim të arkëtimit të të ardhurave.

Mbledhja e të ardhurave ka shënuar një rënie të ndjeshme për Sh.a UK Shkodër me (-17.38%) e ndjekur edhe nga katër shoqëri të tjera. Për Sh.a UK Korçë dhe Sh.a UK Durrës rënia e nivelit të arkëtimit është e papërfillshme.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 12. Norma e Arkëtimit për grupin e II-të, Viti 2016

Në grupin e dytë nga 25 shoqëri, 12 kanë arritur nivelin e normës së arkëtimit mbi 82% që është niveli i performancës së mirë i përcaktuar nga ERRU nga 13 që ishin në vitin 2015.

Në grupin e dytë këtë vit është futur dhe Sh.a UK Belsh një shoqëri e re e formuar në kuadër të riorganizimit të shoqërive UK sipas reformës administrative. Niveli prej 78.21% i kësaj shoqërie e fut atë në brezin e performancës së pranueshme (60%-82%) ku janë 13 shoqëri.

Ecuria e treguesit të Normës së Arkëtimit për grupin e dytë të shoqërive paraqitet në tabelën 18 si më poshtë.

Tabela 18. Ecuria e Normës së Arkëtimit për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
U	Shkodër Fshat	57.01	60.84	76.77	15.93
U	Selenicë	91.46	77.36	91.41	14.05
U	Gramsh	88.50	84.02	92.27	8.25
U	Lushnjë Fshat	88.01	91.26	98.47	7.21
U	Kurbin	73.71	86.99	93.40	6.41
UK	Mallakastër	85.61	74.79	79.86	5.07
U	Ura Vajgurore	104.56	91.67	95.45	3.78
UK	Gjirokastrë	93.16	95.11	98.71	3.60
UK	Lushnjë	90.49	90.38	90.53	0.15
U	Bilisht	104.92	103.95	103.00	0.95
U	Korçë Fshat	92.95	82.74	81.77	0.97
UK	Lezhë	72.75	82.54	81.52	1.02
UK	Rrogozhinë	94.23	77.94	76.41	1.53
UK	Kukës	71.80	71.41	69.40	2.01
UK	Patos	88.55	81.25	77.15	4.10
UK	Librazhd	99.62	101.60	97.07	4.53
UK	Peshkopi	70.93	74.58	68.88	5.70
UK	Peqin	113.55	84.76	77.28	7.48
U	Përmet	95.59	100.89	89.56	11.33
UK	Krujë	74.03	78.17	65.63	12.54
UK	Burrel	82.67	95.80	82.82	12.98
UK	Tepelenë	91.19	89.82	75.05	14.77
UK	Pogradec	83.36	113.03	95.49	17.54

Krahasuar me vitin 2015, norma e arkëtimit për vitin 2016 për 9 nga 25 shoqëri të këtij grupi ka pasur tendencë pozitive. Rritja më e madhe e nivelit të arkëtimit në këtë grup është 15.93% dhe ajo më e vogël 0.15% .

Norma e Arkëtimit ka patur tendencë negative për shumë nga shoqëritë e këtij grupi, 14 prej tyre kanë arkëtuar më pak të ardhura se një vit më parë. Rënie të konsiderueshme kanë shënuar Sh.a UK Pogradec me (-17.54%).

Për Sh.a UK Bilisht megjithëse norma e arkëtimit është ulur krahasuar me vitin 2015, duhet theksuar se norma e arkëtimit e ka kaluar 100%, dhe rënia e nivelit të arkëtimit krahasuar me një vit më parë ka të bëjë me arkëtimin e detyrimeve të prapambetura.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 13. Norma e Arkëtimit për grupin e III-të, Viti 2016

Në grupin e tretë ku bëjnë pjesë 21 shoqëri, për shtatë shoqëri Norma e Arkëtimit për vitin 2016 është më e madhe se 82%, pra në nivelin e performancës së mirë, 11 shoqëri janë në nivelin e performancës së pranueshme (60-82%) dhe 3 shoqëri në nivelin e performancës së dobët nën 60%.

Shoqëria me performancën më të mirë është Sh.a UK Mirditë* me 113% që tregon se ka arkëtuar dhe debi të prapambetura. Në nivelin e performancës së pranueshme janë pjesa më e madhe e shoqërive. Shoqëritë që paraqiten më mirë në këtë brez performance janë Sh.a U Çorovodë, Sh.a UK Orikum, Sh.a U Këlcyrë, Sh.a U Poliçan, Sh.a U Bulqizë dhe Sh.a U Has.

Në brezin e performancës së dobët janë Sh.a UK Novoselë, Sh.a U Tropojë dhe Sh.a U Pukë fshat. Më poshtë në tabelën 19 paraqitet ecuria e treguesit të normës së arkëtimit për grupin tre gjatë tre viteve të fundit.

Tabela 19. Ecuria e Normës së Arkëtimit për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
U	Vau i Dejës	61.82	71.76	87.63	15.87
U	Çorovodë	69.55	69.45	78.96	9.51
U	Tropojë	36.04	50.89	56.35	5.46
UK	Orikum	62.29	73.23	77.06	3.83
U	Divjakë	90.43	86.28	89.55	3.27
UK	Mirditë	66.05	112.06	113.00	0.94
U	Has	66.36	70.66	71.06	0.40
U	Gjirokastrë Fshat	94.90	94.26	93.83	0.43
U	Bulqizë	65.24	75.57	74.75	0.82
U	Poliçan	77.58	78.48	75.33	3.15
U	Novoselë	56.37	62.97	59.78	3.19
UK	Libohovë	63.93	68.60	65.08	3.52
UK	Fushë Arrëz	78.66	74.16	68.33	5.83
UK	Delvinë	78.69	68.04	61.99	6.05
UK	Krastë	100.17	90.30	82.89	7.41
UK	Fushë Krujë	63.38	76.14	65.65	10.49
UK	Ersekë	106.11	101.90	91.06	10.84
U	Këlcyrë	97.37	87.71	76.42	11.29
U	Pukë Fshat	73.73	65.00	49.39	15.61
UK	Bashkia Pukë	126.52	110.00	88.21	21.79
UK	Rubik	91.57	93.81	68.39	25.42

Nga 21 shoqëri të këtij grupi 5 shoqëri kanë përmirësuar nivelin e arkëtimit, 13 kanë pësuar rënie të këtij treguesi dhe vetëm 3 shoqëri kanë luhatur të pa konsiderueshme.

Tendencën pozitive më të mirë në këtë grup për rritjen e treguesit të normës së arkëtimit krahasuar me vitin 2015 e kanë shënuar Sh.a. U Vau Dejës (+15.87%) ndërsa tendencën më të madhe negative në grup e ka shënuar Sh.a UK Rubik e cila e ka ulur nivelin e arkëtimit në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 me (-25.42%). Për këtë arsye kjo shoqëri nga performanca shumë e mirë në vitin 2015 ka kaluar në nivelin e performancës së pranueshme në vitin 2016.

Përfundime

Norma mesatare e arkëtimit për sektorin në fund të vitit 2016 shënoi një regres shumë të vogël me (+0.5%) krahasuar me vitin 2015. Në vitin 2016 për 57 shoqëritë e marra në analizë, 25 shoqëri rezultojnë me normë arkëtimi në nivelin e performancës së mirë, të përcaktuar nga ERRU, katër nga të cilat e kanë normën e arkëtimit mbi 100%. Në nivelin e performancës së pranueshme (60%-82%) janë 29 shoqëri dhe në nivelin e performancës së dobët, nën 60%, janë 3 shoqëri.

Ky tregues si sektor është përmirësuar por gjatë analizës individuale është vërejtur në përgjithësi një përkeqësim i këtij niveli. Për 25 shoqëri ky tregues ka pësuar rënie të konsiderueshme. Kjo

tregon se menaxherët e shoqërive me stafet përkatëse nuk kanë bërë përpjekjet e duhura për arkëtimin e faturave për shërbimin UK.

Një arsye tjetër është dhe fakti se disa shoqëri janë riorganizuar gjatë vitit 2016 dhe shoqërive ekzistuese i janë bashkangjitur dhe shoqëri me nivele të ulëta arkëtimi gjë që ka ndikuar në përkeqësimin e këtij treguesi. Një efikasitet mirë në arkëtimin e të ardhurave ka të bëjë me fuqizimin financiar të shoqërisë që ndikon drejtpërdrejt në aftësinë paguese të shoqërisë. Rritja e aftësisë paguese të shoqërisë bën të mundur likuidimin e detyrimeve ndaj punonjësve, furnitorëve, shlyerjes së interesave të kredive të marra, që do të thotë shlyerje në kohë e detyrimeve ndaj të tretëve.

Për ERRU, shembulli i performuesve më të mirë duhet të ndiqet edhe nga shoqëritë për të cilat ky tregues nuk ka nivelin e kërkuar si dhe ato që nuk kanë pasur ecuri pozitive në mbledhjen e të ardhurave.

2.4.5 Niveli i Matjes

Raporti i lidhjeve me matës kundrejt numrit total të lidhjeve është Niveli i Matjes. Ky tregues analizon vetëm lidhjet me matësa të kategorive të konsumatorëve dhe nuk pasqyron nivelin e matjes në sistemin e furnizimit me ujë. Rritja e nivelit të matur të ujit, rrit saktësinë dhe tek treguesi "Uji pa të Ardhura".

Ky tregues për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitiv duke e rritur nivelin mesatar në 64.6% krahasuar me 64% për vitin 2015 dhe 61.2 % që ishte për vitin 2014. Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, objektivi i këtij treguesi për vitin 2016 është 80 %, pra përsëri është shumë larg realizimit pasi mesatarja e nivelit të matjes për vitin 2016 është 64.6 % dhe nëse marrim parasysh rritjen progresive të viteve të mëparshme e cila është rritur me 2% nga viti në vit, për vitin 2016 është rritur me 1%.

Kjo tregon punën e dobët nga ana e shoqërive duke bërë që rritja të jetë shumë e papërfillshme nga viti në vit dhe duke çuar në mos realizim të treguesve. Ky tregues është shumë i rëndësishëm pasi ndikon drejtpërsëdrejti në cilësinë e shërbimit për konsumatorët si dhe në rezultatet e disa treguesve të tjerë. ERRU ka vënë objektivi për të gjitha shoqëritë vlerën 85%, por sipas ecurisë ndër vite, mbetet ende shumë punë për tu bërë në këtë drejtim në arritjen e këtij treguesi.

Grupi i parë i shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 14 . Niveli i Matjes për grupin e I-rë, Viti 2016

Për shkak të riorganizimit të shoqërive sipas VKM 63, shoqëria Sh.a UK Korçë e cila për shumë vite me radhë ka qenë shoqëria e vetme me treguesin 100 % në shërbimin e furnizimit me ujë të matur, këtë vit ka rënie me 3.56 % pas përfundimit të riorganizimit të shoqërisë dhe shtimit të zonës së re të shërbimit me disa njësi administrative që më parë furnizimi me ujë kryhej nga ish Ujësjiellës Sh.a U Korçë fshat dhe disa njësi të tjera administrative shërbimin e të cilave e kryenin ish komunat.

Sh.a UK Durrës është i vetmi operator në këtë grup që ka pësuar rritje me 7.32 % krahasuar me vitin 2014 dhe 2.85% krahasuar me vitin 2015 duke çuar nivelin e matjes në 87.35 % dhe duke kaluar kështu kufirin e performancës së mirë prej 85 %, e cila është e vendosur nga ERRU, si dhe duke kaluar dhe objektivin e vendosur në strategjinë kombëtare e cila për vitin 2016 është 80 %. Shoqëritë e tjera kanë nivelin e matjes nën kufirin e performancës së mirë prej 85 %. Ecuria e Nivelit të Matjes për shoqëritë e grupit të parë paraqitet e detajuar për tre vitet e fundit më poshtë në tabelën 20.

Tabela 20. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Shkodër	37.14	39.22	51.85	12.63
UK	Berat - Kuçovë	43.11	44.56	49.69	5.13
U	Elbasan Fshat	58.60	55.92	59.93	4.01
UK	Durrës	80.03	84.50	87.35	2.85
UK	Sarandë	65.13	64.93	67.58	2.65
UK	Kavajë	47.90	48.42	51.03	2.61
UK	Elbasan Qytet	60.43	64.29	66.07	1.78
UK	Fier	54.62	54.79	54.73	0.06
UK	Tiranë	77.64	78.98	77.09	1.89
UK	Vlorë	26.92	40.74	37.79	2.95
UK	Korçë	100.00	100.00	96.44	3.56

Në këtë grup për vitin 2016, rritje të këtij treguesi kanë pasur 7 shoqëri, ku 6 shoqëri prej të cilave kanë rritje shumë të vogël që shkon nga 1.78% në 5.13%.

Shoqëria me progres më të mirë për këtë vit ka qenë Sh.a UK Shkodër me një përmirësim të këtij treguesi me 12.63%, i cili është edhe niveli më i mirë i rritjes krahasuar me vitin 2015. Megjithatë, kjo shoqëri edhe pse ka bërë një përmirësim shumë të mirë të këtij treguesi përsëri ka ende shume punë për të arritur në nivelet e kënaqshme të këtij treguesi.

Në pamje të parë duket se Sh.a UK Korçë ka përkeqësim të këtij treguesi për vitin 2016. Ulja nivelit të matjes për këtë shoqëri ka ardhur si rezultat i kryerjes së riorganizimit në kuadër të reformës, tashmë shoqërisë i janë bashkëngjitur edhe disa zona ku shërbimi i furnizimit me ujë nuk matet.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 15. Niveli i Matjes për grupin e II-të, viti 2016

Ky grup ka pasur 21 shoqëri, ndërsa për vitin 2016 kemi një rritje të numrit të shoqërive në këtë grup. Tani janë 25 shoqëri, prej të cilave 3 shoqëri kanë kaluar nga grupi i tretë si: Sh.a U Ura Vajguore, Sh.a U Selenicë, Sh.a UK Peqin, si dhe Sh.a UK Belsh, i cili është operator i ri i licencuar për herë të parë në vitin 2016.

Edhe për këtë vit Sh.a U Lushnje Fshat vazhdon të ketë këtë tregues 100%. Kjo shoqëri ka pasur në zonën e saj të shërbimit njësi administrative nga 4 Bashki (Lushnje, Fier, Ura Vajguore, Divjakë), të cilat me të mbaruar procesi i riorganizimit do i kalojnë shoqërive të Bashkive përkatëse.

Me gjithë përpjekjet për rritjen e nivelit të matjes numri i shoqërive që nuk arrijnë të afrohen në kufirin e performancës së mirë është shumë i lartë.

Në tabelën 21, si më poshtë paraqitet ecuria e këtij treguesi për grupin e dytë sipas tre viteve të fundit.

Tabela 21. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
UK	Tepelenë	36.65	36.65	61.73	25.08
U	Patos	0.03	0.04	19.16	19.12
U	Ura Vajgurore	66.31	65.07	75.52	10.45
UK	Peshkopi	25.85	27.96	36.72	8.76
UK	Gjirokastrë	0.76	1.00	6.20	5.20
U	Selenicë	0.68	1.23	5.52	4.29
U	Shkodër Fshat	23.10	28.98	33.16	4.18
U	Korçë Fshat	45.73	42.32	45.51	3.19
U	Përmet	61.72	65.46	68.08	2.62
UK	Lezhë	62.30	64.40	66.46	2.06
U	Kurbin	3.91	11.01	13.03	2.02
U	Gramsh	43.44	43.89	45.61	1.72
UK	Librazhd	93.91	93.97	95.17	1.20
UK	Pogradec	93.95	97.99	99.19	1.20
UK	Lushnjë	77.35	79.54	80.69	1.15
UK	Kukës	36.05	28.18	29.30	1.12
U	Bilisht	96.57	97.76	98.45	0.69
U	Lushnjë Fshat	100.00	100.00	100.00	0.00
UK	Rrogozhinë	63.90	63.27	63.21	0.06
UK	Mallakastër	42.17	30.25	29.38	0.87
UK	Peqin	74.43	83.51	81.92	1.59
UK	Burrel	47.93	46.94	44.59	2.35
UK	Krujë	86.26	85.56	73.67	11.89

Në vitin 2016, me përjashtim të pesë shoqërive, niveli i shërbimit të matur është rritur krahasuar me vitin 2015. Rritje të dukshme për këtë vit kanë 5 shoqëri duke filluar nga Sh.a UK Tepelenë e cila ka edhe rritjen më të madhe të shërbimit të matur me 25.08 %, duke vijuar me Sh.a UK Himarë, Sh.a U Patos, Sh.a U Ura Vajgurore dhe Sh.a UK Peshkopi. Për 12 shoqëritë e tjera të cilat kanë përmirësim të këtij treguesi, rritja varion nga 0.69 % - 5 %.

Përkeqësim të këtij treguesi kanë pasur 5 (pesë) shoqëri, por për tu përmendur është Sh.a UK Krujë, e cila ka patur një rënie të këtij treguesi me 11.89 %, i cili është edhe niveli më i lartë i përkeqësimit të nivelit të matjes në këtë grup krahasuar me vitin 2015. Kjo situatë ka bërë që shoqëria të zbresë nën kufirin e performancës së mirë ku ka qenë një vit më parë. Për katër shoqëritë e tjera ulja e nivelit të matur nuk është e ndjeshme por gjithsesi tendenca nuk është pozitive.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 16. Niveli i Matjes për grupin e III-të, Viti 2016

Grupi i tretë përbëhet nga 21 shoqëri dhe duke qenë grupi i shoqërive të vogla vazhdon të jetë grupi me shërbimin e matur në nivelet më të ulëta. Nga shoqëritë e këtij grupi janë 2 (dy) shoqëri që nuk raportojnë të dhëna për disa vite radhazi si: Sh.a U Orikum, Sh.a UK Krastë, gjithashtu janë dhe 3 (tre) shoqëri të tjera, të cilat dy vitet e fundit nuk kanë raportuar ndërsa këtë vit kanë filluar të raportojnë si: Sh.a U Skrapar, Sh.a U Tropojë, Sh.a UK Libohovë.

Mesatarja e grupit për këtë tregues është e ulët, pasi vetëm 3 (tre) shoqëri janë me nivel matje mbi 50 %, 6 (gjashtë) shoqëri kanë nivelin e matjes nga 30 në 50%, pjesa tjetër e shoqërive raportojnë vlera shumë të ulëta.

Ecuria e Nivelit të Matjes gjatë tre viteve të fundit për këtë grup paraqitet më poshtë në tabelën 22.

Tabela 22. Ecuria e Nivelit të Matjes për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (%)	2015 (%)	2016 (%)	Ndryshimi 2016-2015 (%)
U	Tropojë	0.00	0.00	34.84	34.84
U	Këlcyrë	3.99	3.99	26.75	22.76
U	Çorovodë	0.00	0.00	6.51	6.51
U	Has	58.68	60.73	62.97	2.24
UK	Delvinë	40.62	38.62	40.72	2.10
U	Bulqizë	11.93	10.72	11.62	0.90
U	Vau i Dejës	7.46	8.78	9.53	0.75
UK	Mirditë	34.40	42.81	43.45	0.64
UK	Fushë Krujë	19.82	34.42	34.85	0.43
UK	Libohovë	0.00	0.00	0.26	0.26
U	Pukë Fshat	1.58	1.58	1.72	0.14
U	Divjakë	100.00	100.00	100.00	0.00
UK	Orikum	0.00	0.00	0.00	0.00
UK	Krastë	0.00	0.00	0.00	0.00
U	Gjirokastër Fshat	0.51	0.26	0.24	0.02
U	Novoselë	4.75	4.74	4.70	0.04
UK	Fushë Arrëz	1.97	1.49	1.15	0.34
UK	Bashkia Pukë	45.43	44.02	43.02	1.00
UK	Ersekë	65.55	67.61	66.27	1.34
U	Poliçan	56.45	55.48	48.40	7.08
UK	Rubik	30.85	31.14	18.29	12.85

Për shoqëritë e këtij grupi jo vetëm niveli i matjes është i ulët por edhe përpjekjet për përmirësimin e situatës lënë për të dëshiruar. Rritja e nivelit të matur për 6 shoqëri është e papërfillshme, shoqëritë Sh.a UK Orikum dhe Sh.a UK Krastë nuk kanë bërë asnjë përpjekje për vendosje të matësve.

Në këtë grup vlen për tu përmendur Sh.a U Tropojë e cila në vitin 2015 nuk kishte asnjë konsumator të pajisur me matës, ndërsa në vitin 2016 numri i konsumatorëve të pajisur me matës ka arritur 34.84%. Po kështu edhe Sh.a U Këlcyrë ka një rritje të dukshme të nivelit të matjes me 22.76% krahasuar me vitin 2015. Megjithatë këto shoqëri mbeten në shoqëritë me performancë të dobët.

Shoqëritë të cilat e kanë përkeqësuar nivelin e shërbimit të matur janë 7, por për tre nga këto nuk mund të flasim për nivel matje pasi shërbimi i matur në rastin më të mirë nuk e kalon 5%. Shoqëritë të cilat kanë përkeqësuar ndjeshëm nivelin e matjes për vitin 2016 janë Sh.a UK Rubik dhe Sh.a U Poliçan. Për shoqëritë e tjera ulja e nivelit të matur në vitin 2016 krahasuar me vitin 2015 është rreth 1%.

Përfundime

Viti 2016 ka qenë një vit i vështirë për shoqëritë UK pasi kanë qenë në proces riorganizimi, kalimit të zonave nga një shoqëri në një tjetër ose përfshirjen e zonave të reja të pambuluara me shërbim më parë nga shoqëritë e licencuara. Mesatarja e nivelit të shërbimit të matur në sektor për këtë vit ka arritur në rreth 64.6% krahasuar me nivelin e matjes në vitin 2015 është rritur me 0.6 %. Të dhënat tregojnë se ende nuk ka përfunduar vendosja e matësve për të gjithë klientët jo familjarë, me gjithë përpjekjet e shoqërive për të përfunduar këtë proces.

Eliminimi i praktikës aforfe dhe zbatimi i programeve për instalimin e matësve individual dhe në prodhim duhet të jetë në fokus të punës së operatorëve. ERRU, e konsideron procesin e vendosjes së matësve plotësisht të arritshëm nga shoqëritë UK si dhe mbështet e nxit të gjithë operatorët për hartimin dhe zbatimin e programeve për instalimin e matësve individual dhe në prodhim.

Shoqëritë UK kanë vazhduar punën për pajisjen me matës të konsumatorëve në zonën e tyre të shërbimit. Ecuria e këtij treguesi për sektorin në përgjithësi ka qenë pozitive. Niveli mesatar i shërbimit të matur në vitin 2016 është 64.6 % nga 64% në vitin 2015. Matja e konsumit të ujit ul nivelin e shpërdorimit të ujit, humbjet financiare të shoqërive dhe gjithashtu i krijon mundësi operatorëve të përshtatin prodhimin me kërkesën për ujë.

Niveli i shërbimit të matur vazhdon të ketë rritje por serish faturimi aforfe vazhdon të jetë në nivel të lartë. Shoqëritë të cilat kanë instaluar matësit për të gjithë konsumatorët në zonën e tyre të shërbimit janë të pakta në numër. Pjesa më e madhe e shoqërive ofron shërbim të matur dhe të pamatur. Për 9 shoqëri shërbimi i matur është në nivel të papërfillshëm nën 10 %. Për të tre grupet janë 7 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë përse i përket shërbimit të matur (2 janë në grupin e parë, 4 në grupin e dytë dhe vetëm 1 shoqëri në grupin e tretë). Grupi i tretë vazhdon të jetë grupi me performancë më të dobët për këtë tregues pasi ka shoqëri që pothuajse nuk e masin fare këtë shërbim.

ERRU në mënyrë të vazhdueshme ka monitoruar situatën lidhur me vendosjen e matësve duke zhvilluar dhe inspektime në shoqëritë por gjendja ende mbetet në nivele jo të kënaqshme.

2.4.6 Efiçenca e Stafit

Efiçenca e Stafit është treguesi që na lejon të kuptojmë se si janë menaxhuar burimet njerëzore nga shoqëritë UK, potencialin që duhet shfrytëzuar për rritjen e efiçencës në punë, dhe në këtë mënyrë të rritjes së efiçencës së përgjithshme të shoqërisë. Duke qenë se kostot e personelit për momentin zënë një përqindje të madhe të kostove O&M të shoqërive UK, ky tregues merr rëndësi të veçantë prandaj edhe është përfshirë në listën e treguesve kryesorë të performancës. Duke marrë parasysh specifikat e operimit dhe shërbimit të shoqërive si shtrirjen e shërbimit UK, numrin e sistemeve të furnizimit me ujë e të tjera arsye, ERRU ka vendosur nivel të diferencuar të objektivit të performancës së mirë për të tre grupet e shoqërive. Në vitin 2016 kostot e personelit zënë rreth 46% të kostove O&M të shërbimeve ujësjellës kanalizime. Niveli mesatar i punonjësve për 1000 lidhje UK për sektorin është 5.34 nga 5.53 që ishte në fund të vitit 2015.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 17. Efiçenca e Stafit për grupin e I-rë, Viti 2016

Për grupin e parë, ERRU ka përcaktuar si nivel të performancës shumë të mirë deri në 4 punonjës për 1000 lidhje, performancë të pranueshme 4-6 punonjës për 1000 lidhje, dhe mbi 6 punonjës për 1000 lidhje atë të performancës së dobët. Në këtë grup në zonën e performancës së mirë renditen tre shoqëri Sh.a UK Korçë e cila ka edhe performancën më të mirë me 2.15 punonjës për 1000 lidhje, Sh.a UK Tiranë si dhe Sh.a UK Elbasan. Ecuria sipas tre viteve për shoqëritë e grupit të parë paraqitet më poshtë në tabelën 23.

Tabela 23. Ecuria e Efijencës së Stafit për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (S/000/lidhje)	2015 (S/000/lidhje)	2016 (S/000/lidhje)	Ndryshimi 2016-2015 (S/000/lidhje)
UK	Kavajë	7.14	7.96	6.72	1.24
UK	Tiranë	3.67	3.75	3.08	0.67
UK	Berat - Kuçovë	5.51	5.34	4.78	0.56
K	Elbasan Qytet	3.13	3.58	3.26	0.32
UK	Durrës	5.64	5.50	5.24	0.26
UK	Korçë	2.43	2.15	2.06	0.09
U	Elbasan Fshat	10.35	12.35	12.78	0.43
UK	Sarandë	3.53	3.71	4.23	0.52
UK	Fier	6.61	6.37	7.21	0.84
UK	Vlorë	5.17	3.77	4.98	1.21
UK	Shkodër	4.40	4.34	5.97	1.63

Tendencën pozitive më të mirë në grupin e parë e ka pasur Sh.a UK Kavajë, ku numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur me (-1.24) punonjës për 1000 lidhje. Përmirësimi i këtij treguesi ka ardhur si rezultat i uljes së stafit operues mesatarisht me -34 punonjës si dhe i rritjes së numrit të lidhjeve të ujit të pijshëm me +567 lidhje.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 18. Efijenca e Stafit për grupin e II-të, viti 2016

Për grupin e dytë, niveli i objektivit për performancë të pranueshme të vendosur nga ERRU është 6-10 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 10 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 6 punonjës për 1000 lidhje.

Në vitin 2016, pesë shoqëri janë në nivelin e performancës së mirë të përcaktuar nga ERRU dhe konkretisht Sh.a UK Lezhë me (4.52), Sh.a UK Krujë (5.83), Sh.a UK Lushnje me (5.88) Sh.a UK Rrogozhinë me (5.95) si dhe Sh.a UK Burrel me 5.96 punonjës për 1000 lidhje UK. Shoqëria Sh.a UK Pogradec e ka përkeqësuar këtë tregues me (+2.03) duke e zbritur nga niveli i performancës së mirë në nivelin e performancës së pranueshme.

Në nivelin e pranueshëm të këtij treguesi janë 11 shoqëri Këtij grupi i janë bashkangjitur dhe shoqëria Sh.a UK Belsh me 9.56 punonjës për 1000 lidhje që është një shoqëri e re e krijuar në kuadër të riorganizimit të shoqërive UK si dhe Sh.a UK Himarë me 6.5 punonjës për 1000 lidhje për të cilën në vitin paraardhës nuk kishim informacion.

Në zonën e kuqe, atë të performancës së dobët (mbi 10 punonjës për 1000 lidhje) vazhdojnë të mbeten të njëjtat shoqëri që ishin dhe vitin e kaluar. Këtij grupi i është bashkangjitur dhe Sh.a U Selenicë e cila e ka përkeqësuar këtë tregues me (+3.78) punonjës/1000 lidhje.

Ecuria e treguesit efienca e stafit për grupin e dytë sipas tre viteve të fundit paraqitet më poshtë në tabelën 24.

Tabela 24. Ecuria e Efiençës së Stafit për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (S/000/lidhje)	2015 (S/000/lidhje)	2016 (S/000/lidhje)	Ndryshimi 2016-2015 (S/000/lidhje)
UK	Patos	24.16	28.02	19.68	8.34
U	Kurbin	22.05	22.95	16.29	6.66
U	Shkodër Fshat	19.37	20.83	16.30	4.53
U	Lushnjë Fshat	9.60	9.57	6.06	3.51
UK	Peqin	20.01	23.32	20.98	2.34
UK	Tepelenë	9.25	8.88	7.41	1.47
UK	Kukës	8.32	8.78	7.94	0.84
UK	Mallakastër	16.86	16.24	15.55	0.69
UK	Krujë	6.68	6.44	5.83	0.61
U	Gramsh	10.96	10.69	10.32	0.37
UK	Gjirokastrë	7.95	7.65	7.34	0.31
UK	Lezhë	5.25	4.79	4.52	0.27
UK	Burrel	5.21	6.08	5.96	0.12
UK	Lushnjë	5.85	5.90	5.88	0.02
UK	Librazhd	6.69	6.40	6.38	0.02
U	Ura Vajgurore	12.67	13.31	13.48	0.17
U	Korçë Fshat	7.97	7.94	8.16	0.22
U	Bilisht	8.27	8.56	9.00	0.44
UK	Rrogozhinë	5.32	5.23	5.95	0.72
UK	Peshkopi	9.62	6.64	8.05	1.41
UK	Pogradec	3.31	4.00	6.03	2.03
U	Përmet	11.29	11.51	15.26	3.75
U	Selenicë	7.30	8.06	11.84	3.78

Për vitin 2016, përgjithësisht për shoqëritë e këtij grupi numri i punonjësve për 1000/lidhje është ulur, pra tendenca ka qenë pozitive. Por për tu përmendur janë vetëm 6 shoqëritë e para në tabelën e mësipërme ku ulja e numrit të punonjësve për 1000/lidhje varion nga 1.47

p/1000/lidhje në 8.34 p/1000/lidhje. Për shoqëritë e tjera të këtij grupi ka patur luhatje të vogla pozitive e negative të cilat nuk kanë sjellë ndryshime të dukshme të performancës së shoqërive UK me përjashtim të rasteve që i cituam gjatë analizës së më sipërme.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 19. Efienca e Stafit për grupin e III-të, Viti 2016

Për grupin e tretë niveli i objektivit të vendosur nga ERRU për performancë të pranueshme është 10-15 punonjës për 1000 lidhje, ai për performancë të dobët është mbi 15 punonjës për 1000 lidhje dhe ai i performancës shumë të mirë është nën 10 punonjës për 1000 lidhje.

Në grupin e tretë, 6 nga 21 shoqëri kanë më pak se 10 punonjës për 1000 lidhje. Performuesi më i mirë është Sh.a UK Ersekë me (5.41) punonjës për 1000 lidhje. Në nivelin e performancës së mirë renditen edhe Sh.a U Delvinë, Sh.a UK Fushë Krujë, Sh.a UK Fushë Arrëz, Sh.a U Orikum, si dhe Ndërmarrja UK Bashkia Pukë.

Me performancë të dobët, të renditura mbi vijën e kuqe, janë 7 shoqëri. Sh.a U Gjirokastër Fshat renditet e fundit me (37.81) punonjës për 1000 lidhje. Në brezin e performancës së pranueshme, pra në nivelin 10-15 punonjës renditen 8 shoqëri. Këto shoqëri kanë qenë në këtë zonë edhe në vitin 2015 me përjashtim të dy shoqërive Sh.a U Çorovodë si dhe Sh.a UK Mirditë të cilat kanë kaluar nga performanca e dobët në vitin 2015 në brezin e performancës së pranueshme për vitin 2016.

Më poshtë në tabelën 25 paraqitet ecuria e efiençës së stafit për grupin e tretë për tre vitet e fundit.

Tabela 25. Ecuria e Efijencës së Stafit për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (S/000/lidhje)	2015 (S/000/lidhje)	2016 (S/000/lidhje)	Ndryshimi 2016-2015 (S/000/lidhje)
U	Çorovodë	23.42	17.92	11.14	6.78
U	Has	24.98	25.46	20.61	4.85
UK	Mirditë	12.22	16.83	12.49	4.34
U	Pukë Fshat	31.60	31.60	27.69	3.91
U	Gjirokastër Fshat	55.18	40.14	37.81	2.33
U	Tropojë	18.40	18.72	16.41	2.31
UK	Ersekë	5.81	7.08	5.41	1.67
U	Poliçan	24.45	30.50	28.96	1.54
U	Këlcyrë	13.97	13.97	13.77	0.20
U	Novoselë	15.35	15.72	15.59	0.13
UK	Orikum	9.16	9.24	9.17	0.07
UK	Bashkia Pukë	9.35	9.50	9.43	0.07
UK	Fushë Krujë	8.71	7.58	7.53	0.05
UK	Rubik	9.83	10.68	10.70	0.02
UK	Fushë Arrëz	8.41	8.60	8.64	0.04
U	Dijakë	12.90	12.78	12.86	0.08
U	Bulqizë	13.11	13.38	13.50	0.12
UK	Delvinë	8.57	6.66	7.26	0.60
U	Vau i Dejës	9.23	10.17	11.35	1.18
UK	Krastë	16.82	18.78	19.98	1.20
UK	Libohovë	8.41	10.22	12.76	2.54

Në këtë grup, 13 shoqëri e kanë përmirësuar këtë tregues në vitin 2016 krahasuar me vitin. 2015. Ndryshim pozitiv të ndjeshëm kanë patur Sh.a U Çorovodë, Sh.a U Has, Sh.a UK Mirditë, Sh.a UK Pukë fshat, Sh.a UK Tropojë si dhe Sh.a UK Ersekë. Për këto shoqëri numri i punonjësve për 1000 lidhje është ulur nga 6.78 p/1000/lidhje për Sh.a U Çorovodë deri në 1.67 p/1000/lidhje për Sh.a UK Ersekë. Për shoqëritë e tjera ulja është në nivel jo të konsiderueshëm, por gjithsesi këto përmirësime gjykohen të rëndësishme duke pasur parasysh peshën e kostos së personelit në totalin e kostove.

Përkeqësim të këtij treguesi kanë patur 8 shoqëri ku numri i punonjësve për këto shoqëri është rritur. Për gjashtë prej tyre rritja është e pandjeshme pasi është në nivel të ulët dhe varion nga 0.02 p/1000/lidhje deri në 0.06 p/1000/lidhje. Shoqëria që ka rritjen më të madhe të numrit të punonjësve për 1000/lidhje në vitin 2016 është Sh.a UK Libohovë. Për këtë shoqëri ky tregues për tre vite radhazi ka patur tendencë negative.

Përfundime

Në vitin 2016, treguesi staf për 1000 lidhje është pothuajse në të njëjtin nivel me vitin paraardhës. Raporti nuk ka ndryshuar pasi kemi rritje si të numrit të lidhjeve UK ashtu dhe numrit të punonjësve. Krahasuar me një vit më parë numri i lidhjeve të ujit dhe kanalizimeve në mbyllje të vitit 2016 rezulton i rritur respektivisht me rreth 69000 lidhje uji dhe 38000 kanalizime. Në pamje të parë duket sikur ky tregues do të përmirësohet, por situata nuk ka ndryshuar për arsye se nga ana tjetër edhe numri i punonjësve për shërbimet ujësjellës kanalizime në mbyllje të vitit rezulton se është rritur me 400 punonjës.

Rritja e numrit të punonjësve ka ardhur edhe nga riorganizimi i disa shoqërive por edhe nga tejfryrja me staf e shoqërive ekzistuese. Pothuaj në një numër të konsiderueshëm shoqëri ka rritje të ndjeshme të stafit që merret me aktivitetin e ndërmarrjes si për Sh.a UK Vlorë (+116), Sh.a UK Pogradec (+50), Sh.a UK Shkodër (+40), Sh.a UK Durrës (+20), Sh.a UK Selenicë (+29), Sh.a UK Gramsh (+24) e kështu dhe për shoqëri të tjera. E kundërta ka ndodhur me Sh.a UK Tiranë e cila në mbyllje të vitit 2016 rezulton me 66 punonjës më pak krahasuar me mbylljen e vitit 2015. Për shumë shoqëri numri ka mbetur i pandryshueshëm.

Gjithashtu disa shoqëri janë riorganizuar e disa të tjera jo, kështu që edhe informacioni i dhënë mund të themi që nuk ka saktësinë e duhur për të patur një gjykim më të drejtë si për këtë tregues ashtu dhe për treguesit e tjerë.

Pothuajse 1/4 e shoqërive (14 nga 57) renditen në zonën e performancës së mirë të vendosur për grupet e tyre përkatëse të përcaktuar nga ERRU.

Në kuadër të objektivit të përgjithshëm strategjik të sektorit për të arritur qëndrueshmëri financiare përmes përmirësimeve në mbulimin e kostove, rritja e numrit të punonjësve dhe nivelet e ulëta të produktivitetit të punonjësve mbeten një shqetësim serioz për ERRU-në. Përmirësimi i treguesit të efikasitetit të stafit ndikon direkt në reduktimin e kostove të punës.

Rritja e numrit të punonjësve është e lidhur me kostot e punës, të cilat janë rritur me rreth 6% krahasuar me vitin 2015 ose në vlerë absolute me (+181 milion) lekë. Kjo rritje e kostove ka ndikuar në pamundësinë e shoqërive për të mbuluar kostot e operim mirëmbajtjes e jo më të kostove totale.

Për të nxitur shoqëritë që të rrisin efikasitetin e stafit të tyre, ERRU vendos objektiva individuale për secilën nga shoqëritë ujësjellës kanalizime në procesin e ndryshimit të tarifave. Çelësi i suksesit për arritjen e objektivave të performancës lidhur me këtë tregues qëndron në optimizmin e strukturës organizative, përzgjedhjen e punonjësve të kualifikuar, të motivuar dhe të dedikuar, përcaktimin e procedurave të brendshme operacionale, delegimin e detyrave dhe përgjegjësi si dhe zgjerimin e bazës së klientëve.

Shoqëritë e mëdha dhe ato urbane arrijnë më lehtë nivele të larta të efikasitetit të stafit se sa shoqëritë më të vogla dhe rurale. Gjithsesi analiza e mësipërme tregon se edhe shoqëri të vogla mund të performojnë si duhet kur kanë një menaxhim të mirë.

2.4.7 Kohëzgjatja e Furnizimit me Ujë

Vazhdimësia e furnizimit me ujë lidhet me aftësinë e ndërmarrjes së ujësjellësit për të mbajtur rrjetin e shpërndarjes nën një presion të caktuar shërbimi në mënyrë që t'u japë konsumatorëve të saj në mënyrë të vazhdueshme dhe pa ndërprerje. Megjithatë ky tregues është përmirësuar me kalimin e kohës, shoqëritë UK akoma priren të mbi prodhojnë ujë me qëllim që të plotësojnë nevojat e popullsisë së cilës i shërbejnë, si dhe orët e furnizimit të përditshëm dhe presionin.

Aktualisht, vetëm 5 (pesë) nga shoqëritë e ujësjellësit (Korça, Librazhdi, Bilisht, Rubiku dhe Bashkia Pukë) mund të ofrojnë ujë 24 orë me presion në të gjithë sistemet e tyre gjatë gjithë vitit. Në sisteme të tjera, popullsia e kompenson këtë mungesë të "vazhdimësisë së shërbimit" me anë të blerjes dhe të instalimit të pompave dhe të depozitave të ujit që mbushen kur sistemi i shpërndarjes është me presion.

Faktorët kryesorë që shkaktojnë këtë vazhdimësi të ulët të furnizimit me ujë janë humbjet e ujit nga mbi konsumi i pamatur si pasojë e faturimit aforfe, nga lidhjet e paligjshme dhe nga humbjet teknike në rrjete. Si dy nga treguesit më të rëndësishëm në sektorin e ujit kohëzgjatja e furnizimit me ujë dhe cilësia e tij, kërkojnë dhe vëmendjen më të madhe të shoqërive për përmirësimin dhe si rrjedhojë rrisin të ardhurat e shoqërisë dhe ulin kërkesën e konsumatorëve për burime të tjera të furnizimit me ujë.

Në vlerësimin e këtij treguesi është përdorur mesatarja e orëve të furnizimit me ujë në ditë, tregues i cili për vitin 2015 ka qenë 12 orë/ditë, ndërsa për vitin 2016 është 12.3 orë/ditë pra pa asnjë ndryshim apo përmirësim të mesatares së kohëzgjatjes së furnizimit me ujë pothuajse për vite me radhë. Objektivi prej 12 orë/ditë furnizim me ujë ka qenë për vitin 2011 dhe për 5 vite nuk shihet përmirësim dhe perspektivë për arritje të objektivit për vitin 2016 si dhe për shumë vite në vazhdim.

Objektivi i performancës së mirë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, për vitin 2016 është 18 orë/ditë, e njëjtë me objektivin e vendosur nga ERRU. Nga analiza e bërë për çdo vit ky tregues është larg arritjes së objektivit dhe kërkon shumë punë për përmirësimin dhe arritjen e rezultateve të kërkuara.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 20. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e I-rë, Viti 2016

Për këtë tregues në grupin e parë të shoqërive, nga analiza e bërë gjatë vitit 2016 shihet që ka pasur luhate shumë të vogla të këtij treguesi. Si mesatare e grupit ka një rritje pothuajse të pa përfillshme nga 12.00 orë ujë në ditë për vitin 2015 në 12.3 orë ujë në ditë për vitin 2016.

E vetmja shoqëri që ka bërë përmirësim të këtij treguesi është Sh.a UK Sarandë, e cila për vitin 2016 e ka raportuar furnizimin me ujë 8.00 orë/ditë krahasuar me vitin 2015 që ka qenë 5.69 orë/ditë por përsëri mbetet në kufirin e performancës së dobët për këtë grup dhe shumë larg realizimit të treguesit ose përafrimit të vlerave të grupit.

Shoqëria Sh.a UK Durrës megjithëse është ndër shoqëritë më të mëdha, renditet e fundit për grupin e parë përse i përket kohëzgjatjes së furnizimit me ujë duke kaluar në nivelin me 3.56 orë/ditë furnizim dhe është e vetmja nën kufirin e performancës së dobët me më pak se 8.0 orë/ditë.

Në këtë grup janë 3 shoqëri që operojnë në nivelin e performancës së mirë me mbi 18 orë ujë në ditë dhe është i njëjtë me vitin 2015, si Sh.a UK Korçë, e cila vazhdon me 24 orë ujë në ditë, Sh.a. UK Shkodër me 21.39 orë ujë në ditë dhe Sh.a. UK Fier me 20.96 orë ujë në ditë.

Ecuria e këtij treguesi për grupin e parë të shoqërive për tre vitet e fundit paraqitet më poshtë në tabelën 26.

Tabela 26. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e I-rë

Aktiviteti	Operatori	2014 (orë/ditë)	2015 (orë/ditë)	2016 (orë/ditë)	Ndryshimi 2016-2015 (orë/ditë)
UK	Sarandë	4.55	5.69	8.00	2.31
UK	Fier	20.28	20.26	20.96	0.70
UK	Kavajë	9.29	9.22	9.24	0.02
UK	Korçë	24.00	24.00	24.00	0.00
UK	Elbasan Qytet	11.85	11.85	11.84	0.01
UK	Tiranë	11.04	10.92	10.83	0.09
UK	Shkodër	21.54	21.62	21.39	0.23
UK	Berat - Kuçovë	9.53	9.67	8.88	0.79
UK	Vlorë	13.24	12.82	11.97	0.85
UK	Durrës	7.52	7.37	3.56	3.81
U	Elbasan Fshat	17.75	17.85	13.73	4.12

Përmirësimi i kohëzgjatjes së furnizimit me ujë është një nga detyrat kryesore të shoqërive ujësjellës kanalizime e në veçanti për shoqëritë e grupit të parë të cilat mbulojnë me këtë shërbim një pjesë të konsiderueshme të popullsisë në vend.

Duke përjashtuar Sha UK Korçë e cila ka shërbim të pandërprerë prej 24 orë/ditë të furnizimit me ujë, për të gjitha shoqëritë e tjera ka vend për përmirësim të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë.

Në vitin 2016 për përmirësim të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për grupin e parë mund të përmendim vetëm Sh.a UK Sarandë e cila ka një rritje të përmirësimit të këtij treguesi me 2.31 orë/ditë. Për pjesën më të madhe të shoqërive të këtij grupi tendenca e këtij treguesi nuk ka qenë pozitive pasi kohëzgjatja e furnizimit me ujë pothuajse nuk ka ndryshuar ose është ulur. Uljen më të madhe të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë e ka raportuar Sh.a U Elbasan Fshat dhe Sh.a UK Durrës.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 21. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e II-të, Viti 2016

Shoqëritë Sh.a UK Librazhd dhe Sh.a U Bilisht, vazhdojnë të jenë dy shoqëritë më të mira të këtij grupi me 24 orë/ditë furnizim me ujë për konsumatorët, duke u ndjekur nga shoqëritë që ofrojnë shërbim me mbi 20 orë përkatësisht: Sh.a UK Pogradec 23.72 orë/ditë, Sh.a UK Burrel 22.93 orë/ditë, Sh.a UK Tepelenë 22.44 orë/ditë, Sh.a U Gramsh 20.19 orë/ditë dhe Sh.a UK Lezhë 20.14 orë/ditë

Gjithashtu këtë vit raportime ka bërë dhe Sh.a UK Belsh e cila është shoqëri e re e licencuar në vitin 2016, e cila është krijuar sipas reformës së re territoriale. Kjo shoqëri ka një tregues të kënaqshëm me 11.18 orë/ditë furnizim me ujë.

Në total për grupin e dytë janë 7 shoqëri që operojnë mbi nivelin e performancës së mirë për furnizim me ujë me mbi 18 orë/ditë të vendosur nga ERRU, nga 5 shoqëri që kanë qenë për vitin 2015.

Ecuria e shoqërive në grupin e dytë për tre vitet e fundit pasqyrohet si më poshtë në tabelën 27.

Tabela 27. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e II-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (orë/dite)	2015 (orë/dite)	2016 (orë/dite)	Ndryshimi 2016-2015 (orë/dite)
UK	Burrel	12.67	11.75	22.93	11.18
UK	Tepelenë	15.36	16.49	22.44	5.95
UK	Patos	3.00	3.00	7.08	4.08
UK	Pogradec	21.15	21.43	23.72	2.29
UK	Peqin	8.74	9.40	11.56	2.16
U	Shkodër Fshat	12.12	11.15	13.15	2.00
U	Korçë Fshat	9.42	12.81	14.68	1.87
UK	Kukës	8.92	9.33	10.83	1.50
UK	Krujë	4.32	3.81	4.56	0.75
UK	Lezhë	20.00	19.75	20.14	0.39
U	Gramsh	19.82	19.86	20.19	0.33
UK	Lushnjë	4.69	4.70	5.00	0.30
U	Ura Vajgurore	4.85	5.32	5.59	0.27
UK	Mallakastër	12.27	13.12	13.37	0.25
U	Kurbin	4.57	4.68	4.84	0.16
UK	Peshkopi	9.25	7.75	7.83	0.08
UK	Librazhd	24.00	24.00	24.00	0.00
U	Bilisht	24.00	24.00	24.00	0.00
U	Lushnjë Fshat	6.44	6.35	6.30	0.05
UK	Rrogozhinë	10.70	11.00	10.85	0.15
UK	Gjirokastër	3.62	3.68	3.44	0.24
U	Përmet	11.64	16.54	15.81	0.73
U	Selenicë	10.82	10.82	5.36	5.46

Në grupin e dytë shihet që 16 shoqëri kanë raportuar rritje të këtij treguesi nga 0.08 në 2.29 orë ujë në ditë. Rritjen më të lartë krahasuar me vitin 2015 për këtë grup e ka patur Sh.a UK Burrel me 11.38 orë/ditë. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për Sh.a UK Tepelenë. Rritja e orëve të furnizimit me ujë për këto shoqëri ka bërë që ato të jenë afër kufirit maksimal të furnizimit me ujë, për shoqëritë e tjera përmirësimi i kohëzgjatjes së furnizimit me ujë varion nga 0.16 orë në ditë në 4 orë në ditë.

Në këtë grup janë 5 shoqëri që kanë pasur rënie të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë, ku 4 prej tyre kanë një rënie pothuajse të papërfillshme me 0.05 deri në 0.73 orë/ditë. Rënie më të madhe ka shënuar Sh.a. U Selenicë me 5.46 orë/ditë me pak se në 2015 duke e kaluar këtë shoqëri nën kufirin e performancës së dobët.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 22. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë për grupin e III-të, Viti 2016

Numri i shoqërive të grupit të tretë është zvogëluar për vitin 2016 pasi 3 shoqëri si Sh.a U Ura vajgurore, U Selenicë, UK Peqin kanë kaluar në grupin e dytë. Mesatarja e këtij grupi ka një rritje nga 9.8 orë/ditë për vitin 2015 në 10.5 orë/ditë për vitin 2016 pra me 0.7 orë/ditë. Shoqëri që ofrojnë ujë mbi nivelin e performancës së mirë prej 18 orë/ditë dhe për këtë vit vazhdojnë të jenë 2 shoqëri, Sh.a UK Rubik me 24 orë furnizim me ujë dhe Sh.a. UK Bashkia Pukë me 23.9 orë furnizim me ujë.

Në total në kufijtë e performancës së pranueshme me orare furnizimi midis 8 dhe 18 orë në ditë janë 10 shoqëri nga 11 që kanë qenë në vitin 2015. Shoqëritë e tjera janë në kufijtë nga 3.01 orë/ditë në 8.72 orë/ditë.

Në tabelën 28 të mëposhtme është paraqitur ecuria e kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për grupin e tretë të shoqërive për tre vitet e fundit.

Tabela 28. Ecuria e Kohëzgjatjes së furnizimit me Ujë për grupin e III-të

Aktiviteti	Operatori	2014 (orë/ditë)	2015 (orë/ditë)	2016 (orë/ditë)	Ndryshimi 2016-2015 (orë/ditë)
UK	Bashkia Pukë	21.00	20.00	23.90	3.90
U	Tropojë	9.22	8.74	12.56	3.82
UK	Rubik	24.00	20.67	24.00	3.33
UK	Fushë Arrëz	11.95	12.00	14.33	2.33
UK	Libohovë	7.13	6.06	7.97	1.91
UK	Mirditë	12.95	13.67	15.50	1.83
U	Bulqizë	8.10	6.28	7.40	1.12
U	Çorovodë	6.00	6.00	7.08	1.08
UK	Fushe Krujë	15.00	5.50	6.00	0.50
U	Novoselë	16.75	6.41	6.83	0.42
UK	Orikum	3.58	3.04	3.28	0.24
U	Pukë Fshat	14.92	14.92	14.91	0.01
U	Has	7.40	7.44	7.42	0.02
U	Divjakë	3.78	4.85	4.82	0.03
UK	Krastë	1.32	3.30	3.01	0.29
U	Gjirokastrë Fshat	8.01	11.56	11.14	0.42
U	Poliçan	12.27	12.47	11.73	0.74
U	Këlcyrë	7.00	7.00	6.04	0.96
UK	Ersekë	21.97	17.46	15.98	1.48
U	Vau i Dejës	11.29	10.55	8.72	1.83
UK	Delvinë	10.08	11.66	7.84	3.82

Për shoqëritë e këtij grupi përmirësim të kohëzgjatjes së furnizimit me ujë kanë patur 11 shoqëri. Rritja e orëve të furnizimit me ujë për shoqëritë e këtij grupi varion nga 0.24 orë/ditë deri në 3.9 orë/ditë. Rritja më e madhe është shënuar nga Sh.a UK Rubik dhe Sh.a. UK Bashkia Pukë, për 8 shoqëri rritja varion nga 1.08-3.9 orë/ditë ndërsa tre shoqëri kanë pasur rritje pothuajse të pa konsiderueshme.

Rënie të këtij treguesi kanë raportuar 10 shoqëri nga ku 7 shoqëri kanë rënie të lehtë në më pak se 0.96 orë/ditë ndërsa rënie më të madhe kanë 3 shoqëri UK Ersekë, U Vau - Dejës, U Delvinë e cila varion nga 1.48 orë/ditë në 3.82 orë/ditë.

Përfundime

Ky është ndër treguesit që ka ecurinë me të dobët nga viti në vit dhe shume larg realizimit për furnizimin me ujë të klientëve 18 orë në ditë që është objektivi i performancës së mirë të përcaktuar në Strategjinë Kombëtare të Furnizimit me Ujë dhe Kanalizime 2011- 2017, e cila për vitin 2016 është 18 orë/ditë, e njëjtë me objektivin e vendosur nga ERRU. Kjo kërkon shumë punë për përmirësimin dhe arritjen e rezultateve të kërkuara gjithashtu kërkon dhe mbështetjen e institucioneve përgjegjëse për dhënien e fondeve për të bërë të mundur përmirësimin e situatës aktuale. Për vitin 2015 ky tregues ka qenë 12 orë/ditë, ndërsa për vitin 2016 është 12.3 orë/ditë pra pa asnjë ndryshim apo përmirësim të mesatares së kohëzgjatjes së furnizimit me ujë pothuajse për vite me radhë.

Pjesa më e madhe e klientëve nuk furnizohen në mënyrë të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur. Mungesa e furnizimit të vazhdueshëm, pavarësisht shkaqeve si furnizimi i ujit me ndërprerje periodike, ndryshimet në presionin e ujit, shpimi i tubave nga lidhjet e paligjshme, mbajtja e ujit në depozita dhe pompat thithëse të instaluar nga konsumatorët etj. ndikon edhe në cilësinë e ujit. Kohëzgjatja e furnizimit me ujë varion nga 3-24 orë ujë në ditë. Operatorët ofrojnë furnizimin me ujë sipas një grafiku të përcaktuar. Janë 5 operatorët që ofrojnë furnizim të pandërprerë me ujë dhe me presionin e duhur (Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Librazhd, Sh.a U Bilisht, Sh.a UK Rubik dhe UK Bashkia Pukë me furnizim me ujë 23.9 orë/ditë).

Rënie më të madhe përsa i përket kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për të gjithë grupet kanë raportuar 4 shoqëri (Sh.a U Selenicë me 5.46 orë/ditë, Sh.a U Elbasan Fshat me 4.12 orë/ditë, Sh.a U Delvinë me 3.82 orë/ditë dhe Sh.a UK Durrës me 3.81 orë/ditë). Nga gjithë shoqëritë ajo që tërheq vëmendjen është Sh.a UK Durrës e cila edhe pse është në shoqëritë më të madha ka këtë rënie kaq drastike të pa justifikuar pasi me reformën e re i janë larguar shumë pak zona dhe duhej të rritej ky tregues jo të ndodhte e kundërta. Mundësia është që ky operator këtë vit të ketë raportuar realisht situatën përsa i përket furnizimit me ujë e cila për vitin 2016 ka qenë 3.56 orë/ditë.

Rritje më të madhe përsa i përket kohëzgjatjes së furnizimit me ujë për të gjithë grupet kanë raportuar 11 shoqëri me mbi 2 orë/ditë më shumë furnizim me ujë se sa gjatë vitit 2015. Me rritjen më të lartë është Sh.a UK Burrel me 11.18 orë/ditë, më pas vjen Sh.a UK Tepelenë me 5.95 orë/ditë, Sh.a U Patos me 4.08 orë/ditë, UK Bashkia Pukë me 3.9 orë/ditë, Sh.a U Tropojë me 3.82 orë/ditë dhe Sh.a UK Rubik me 3.33 orë/ditë. Shoqëritë Sh.a UK Sarandë, Sh.a UK Pogradec, Sh.a U Shkodër fshat (Malësi e Madhe), Sh.a UK Peqin dhe Sh.a UK Fushë- Arrëz kanë rritje 2-2.31 orë/ditë.

Po të krahasojmë vitin 2015 me vitin 2016 në total janë po 35 shoqëri që kanë qenë mbi nivelin e performancës së dobët prej 8 orë furnizim me ujë në ditë.

Shihet se arritja e niveleve të pranueshme në oraret e furnizimit nuk varet vetëm nga investimet, por mund të arrihet edhe nëse menaxhohet me profesionalizëm. Nga ana e shoqërive duhet shumë punë për arritjen e këtyre niveleve.

ERRU do të mbështesë operatorët për të gjetur rrugët dhe mundësitë për përmirësime të mëtejshme të situatës dhe më pas monitorimin e ecurisë së tyre sipas objektivave të vendosur.

2.4.8 Mbulimi me kanalizime

Raporti i popullsisë që i ofrohet shërbimi i grumbullimit dhe i largimit të ujërave të ndotura me popullsinë që jeton në zonën e juridiksionit të një shoqërie UK përfaqëson të ashtuquajturin Treguesin e Mbulimit me Kanalizime. Me përfundimin e organizimit të shoqërive sipas reformës territoriale të gjitha shoqëritë që operojnë në Shqipëri do të kryejnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe atë të kanalizimeve. Meqenëse ky organizim nuk ka përfunduar akoma, edhe për këtë vit analiza do të fokusohet vetëm në ato shoqëri që kryejnë këtë shërbim. Në vendin tonë vetëm 34 shoqëri të licencuara ofrojnë këtë kategori shërbimi. Për vitin 2016, mesatarja e këtij treguesi në nivel kombëtar është 50,7%, krahasuar me shërbimin e furnizimit me ujë që për këtë vit është 79,4%, ky shërbim vazhdon të mbetet shumë larg kufirit të performancës së mirë 75% që ERRU ka përcaktuar për këtë tregues.

Shërbimi me kanalizime bëhet më cilësorë nëpërmjet impianteve të trajtimit të ujërave të ndotur ku për vitin 2016, nga tetë impiante të ndërtuara vetëm 4 prej tyre janë në punë. Mbetet domosdoshmëri vënia në punë e impianteve të ndërtuara dhe krijimi i mundësive për të ndërtuar impiante të reja për të rritur cilësinë e këtij shërbimi në të gjithë territorin e vendit duke krijuar njëkohësisht mbrojtje më të madhe të mjedisit.

Grupi i I-rë i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 23. Mbulimi me Kanalizime për grupin e I-rë, Viti 2016

Riorganizimi i shoqërive sipas reformës së re territoriale u shoqërua me ndryshimin e numrit të popullsisë në zonën e juridiksionit dhe të shërbimit të disa shoqërive UK. Për këtë arsye, gjatë vitit 2016, treguesi i mbulimit me kanalizime ka patur luhatje të mëdha për disa shoqëri UK. Mbi kufirin e performancës së mirë performojnë katër shoqëri, gjashtë performojnë dobët ndërsa Sh.a U Elbasan Fshat nuk kryen shërbimin me kanalizime. Për performancën më të mirë në grup, me shkallën e mbulimit 100%, edhe për këtë vit mbetet Sh.a UK Elbasan.

Ecuria

Përkeqësim të treguesit kanë patur Sh.a UK Korçë (-18,5%), Sh.a UK Berat -Kuçovë (-20,52%), Sh.a UK Shkodër (-23,47%) dhe Sh.a UK Fier (-23,27%). Përmirësim të treguesit kanë patur Sh.a UK Tiranë (+16,6%) dhe Sh.a UK Durrës (+1,79%) të cilat janë dhe shoqëritë që kanë performuar mirë për tre vitet e fundit. Trajtimi më cilësor i ujërave të ndotura në këtë grup bëhet nga shoqëritë e licencuara Sh.a UK Durrës, Sh.a UK Korçë dhe Sh.a UK Shkodër.

Grupi i II-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 24. Mbulimi me Kanalizime për grupin e II-të, Viti 2016

Në grupin e dytë të përbërë nga 25 shoqëri, vetëm 13 shoqëri kryejnë shërbimin me kanalizime. Për performancë të mirë me tregues mbi kufirin 75%, janë Sh.a UK Lezhë (86,53%), Sh.a UK Burrel (79,32%), dhe Sh.a UK Pogradec (77,71%).

Sh.a UK Gjirokastrë, nëpërmjet investimeve të kryera, ka rritur treguesin me (+ 24,78%), gjithashtu tendenca në rritje është vënë re edhe tek Sh.a UK Pogradec (+5,68%). Tetë shoqëri UK ofrojnë këtë shërbimin nën kufirin 50% të vendosur për performancë të dobët. Gjatë analizës u vu re se edhe në këtë grup disa shoqëri kanë patur luhatje të mëdha të treguesit si pasojë e riorganizimit të kryer sipas VKM 63, kështu ka ndodhur me Sh.a UK Krujë (-73,42%) dhe Sh.a UK Librazhd (-64,17%). Për tre vitet e fundit, për përkeqësim të situatës mund të flasim edhe për shoqëritë Sh.a UK Lezhë (-8,54%), Sh.a UK Kukës (-6,25%), Sh.a UK Tepelenë (-6,44%), Sh.a UK Mallakastër (-5,64%). Sh.a UK Himarë nuk është marrë në analizë pasi nuk ka të dhëna të besueshme për këtë tregues. Trajtimi i ujërave të ndotura për grupin e dytë kryhet vetëm nga shoqëria Sh.a UK Pogradec, në proces për këtë trajtim më cilësor të ujërave të ndotura janë Sh.a UK Lezhë dhe Sh.a UK Sarandë.

Grupi i III-të i Shoqërive

Performanca për vitin 2016




Figura 25. Mbulimi me Kanalizime për grupin e III-të, Viti 2016

Përgjatë vitit 2016, nga 21 shoqëri të grupit të tretë, nëntë prej tyre kryejnë shërbimin me kanalizime. Sh.a U Çorovodë me tregues të mbulimit (39,42%) i bashkëngjitet shoqërive duke kryer për herë të parë këtë shërbim. Tendenda në rritje është vënë re në Sh.a UK Mirditë (+22,73%) si pasojë e bashkimit me Sh.a UK Rubik, pasuar nga Sh.a UK Ersekë (+16,83%) e cila është e vetmja në grup me tregues 100% të mbulimit me kanalizime. Vetëm tre shoqëri performojnë mbi kufirin 75% të benchmarking, pjesa tjetër performon nën kufirin prej 50%.

Nën efektin e riorganizimit, si pasojë e rritjes së numrit të popullsisë, Sh.a UK Delvinë ka rënien më të madhe të treguesit (-21,59%), pjesa tjetër e shoqërive kanë luhatje të lehta ose të njëjtat

vlera që kanë patur. Për tre vitet e fundit, kanë performuar mirë Sh.a UK Krastë (+7,99%), Sh.a UK Mirditë (18,64%) dhe Ndërmarrja Bashkia Pukë (+3,48%). Asnjë nga shoqëritë e këtij grupi nuk kryen përpunimin e ujërave të ndotura.

Përfundime

Nga analiza për të tre grupet shihet qartë se në Shqipëri, 34 nga 57 shoqëri kryejnë shërbimin me kanalizime, vetëm 10 prej tyre arrijnë të mbulojnë me shërbim mbi 75% të popullsisë, katër shoqëri kanë kaluar prapun e kufirit të vendosur prej 50% të performancës së dobët dhe pjesa më e madhe mbulojnë me shërbim një numër të vogël të banorëve në zonën e tyre të juridiksionit. Përqindja me mbulim në rang vendi për këtë vit është. 50.7%. Mbulimi me shërbim për zonat urbane ofrohet për 78% të popullsisë ndërsa në zonat rurale 7%, vlera këto mjaft të ulëta dhe larg objektivave të vendosura të strategjisë kombëtare. Vëmendja me e madhe mbi zgjerimin e këtij shërbimi, sidomos për zonat rurale, është shqetësim i vazhdueshëm për ERRU. Reforma e re territoriale bëri të mundur përfshirjen pranë shoqërive edhe të zonave që deri me sot nuk kanë qenë të përfshira në zonën e juridiksionit të asnjë shoqërie UK por mbulimi me shërbimin e kanalizimeve i tyre mbetet një sfidë për të gjitha shoqëritë UK të cilat gjatë hartimit të planeve të biznesit duhet të vendosin objektiva për përfshirjen e tyre në zonat ku do të kryhen investime të reja. Trajtimi i ujërave të ndotura kryhet nga katër shoqëri Sh.a UK Durrës, Sh.a UK Korçë, Sh.a UK Pogradec dhe Sh.a UK Shkodër, akoma nuk kanë filluar të funksionojnë impiantet e rinj të ndërtuar për trajtimin e ujërave të ndotura në qytetin e Sarandës, Vlorës dhe Lezhës.

ERRU, si rregullator i sektorit UK, e sheh të domosdoshme prioritetin e qeverisë për reformimin e sektorit UK dhe është gjithmonë e gatshme të mbështesë shoqëritë në punën e tyre për një zhvillim të qëndrueshëm, cilësor duke patur në vëmendje direktivat kryesore të BE-së mbi mjedisin dhe për të plotësuar objektivat strategjike të vendosura.

3. Tema e Veçantë: Reforma në Sektorin UK, Zbatimi i VKM nr. 63, datë 27.01.2016

Viti 2016 ka qenë viti i fillimit të reformës në sektorin e ujësjellës kanalizimeve. Reforma në sektorin e ujësjellës kanalizimeve nënkupton riorganizimin e shërbimeve të ujësjellës kanalizimeve sipas ndarjes së re administrative-territoriale në përputhje me ligjin nr. 115/2014, "Për ndarjen administrative-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë". Akti më i rëndësishëm nënligjor i saj është VKM nr. 63, datë 27.01.2016 "Për riorganizimin e operatorëve që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë të pijshëm, grumbullimin, largimin dhe trajtimin e ujërave të ndotura".

Bazuar në këtë vendim të gjitha shoqëritë UK që ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe largimit e përpunimit të ujërave të ndotura do të marrin në pronësi edhe asetet e ish komunave apo ish bashkive të vogla, duke i shërbyer kështu një zone më të madhe, pra duke përfshirë edhe popullsinë e shërbyer më parë nga ish komunat apo edhe popullsinë e pa shërbyer, të ashtuquajtura zona "të bardha". Ajo përcakton gjithashtu përfshirjen direkte në përgjegjësi të kryetarit të bashkisë për performancën e shoqërive të ujësjellës kanalizimeve, si dhe detyrimin që çdo bashki të ketë përfunduar deri më datë 31 Dhjetor 2016 inventarizimin fizik, vlerësimin dhe regjistrimin e këtyre njësive të shërbimit në strukturën e aseteve dhe kontabilitetin e ujësjellës-kanalizimeve Sh.a, në pronësi të bashkisë, sipas ndarjes administrative territoriale.

Duke patur parasysh përfshirjen e sistemeve rurale në zonën e shërbimit të UK, riorganizimi i sektorit përbën një sfidë mjaft të madhe për shoqëritë dhe bashkitë që të ruajnë apo sigurojnë qëndrueshmërinë financiare duke ofruar shërbime me cilësi për të gjithë konsumatorët. Reforma në këtë drejtim ka rezultuar problematike dhe ka ecur me ritme mjaft të ngadalta dhe në terren paraqet vështirësi të karakterit burokratik dhe ligjor për një zbatim të plotë e efikas të saj.

Mjaft shoqëri nuk arrijnë të plotësojnë kërkesat e reformës për tu regjistruar në QKB sipas zonës së re të shërbimit dhe të aseteve të shtuara në përputhje me ndarjen e re administrative, për shkak të borxheve të trashëguara, sistemeve që administroheshin më parë nga ish- komunat, si dhe mungesën e dokumentacionit për të bërë vlerësimin e tyre

Zonat e reja rurale të përfshira në zonat e reja të shërbimit të shoqërive UK, përbëjnë një barrë shtesë financiare meqenëse ato përfaqësojnë shpenzime operimi shtesë dhe njëkohësisht të ardhura më të vogla nga konsumatorët për shkak të tarifave mjaft të ulëta që aplikoheshin më parë në këto zona, si edhe nga shkalla e ulët e mbledhjes së faturave.

Problem tjetër që haset veçanërisht në bashkitë dhe shoqëritë UK relativisht të vogla dhe në zona të largëta mbetet siguri i kapaciteteve profesionale në pozicionet kyçe të menaxhimit të shoqërive UK në përputhje me kërkesat për kualifikimet që legjislacioni parashikon për këto pozicione.

Theksohet fakti që jo të gjitha njësitë vendore dhe shoqëritë UK janë në kushte të njëjta në lidhje me problematikat e zbatimit të reformës. Disa bashki dhe shoqëri UK janë angazhuar seriozisht

dhe kanë përmbushur në kohë detyrimet në zbatim të reformës. Në këtë grup bëjnë pjesë shoqëritë Sh.a UK Belsh, Sh.a UK Malësi e Madhe dhe Sh.a. UK Elbasan Qytet, të cilat kanë demonstruar se nëse pushteti lokal dhe shoqëritë UK angazhohen seriozisht, ato arrijnë të përmbushin kushtet për të ofruar dhe mbuluar me shërbimet e ujësjellës kanalizimeve të gjithë territorin mbas reformës administrative territoriale.

Pra konstatohet që zbatimi i reformës kërkon një angazhim më të madh të bashkive, shoqërive të UK dhe të institucioneve të tjera në varësi të qeverisë qendrore që kanë lidhje me sektorin. Ndihet nevoja e plotësimit me akte të tjera nënligjore dhe administrative, si dhe e instrumenteve dhe mjeteve financiare për zgjidhjen e problemeve të cituara më sipër.

Është shumë e rëndësishme përmbyllja sa më parë e reformës nga ana e shoqërive UK në bashkëpunim të ngushtë me bashkitë përkatëse, në mënyrë që të kenë mundësi të aplikojnë pranë ERRU-së për licencë për zonën e re të shërbimit dhe njëkohësisht të aplikojnë edhe për tarifa të reja të cilat duhet të jenë të bazuara në një plan konkret biznesi 5 vjeçar.

Shoqëritë e riorganizuar duhet të shohin si prioritet hartimin e një Plani Biznesi 5 vjeçar me planet e veprimit përkatëse për përmirësimin e treguesve të performancës, ku përfshihet veçanërisht një program investimesh fizike, programi i lidhjeve të paligjshme, program i instalimit të ujëmatësve, përmirësimit të normës së arkëtimit etj.

Situata deri në fund të vitit 2016 nuk rezulton aspak e mirë sa i përket zbatimit të reformës, e cila po ecën me ritme shumë të ngadalta, përveç tre (3) shoqërive që përmendëm më sipër të cilat janë riorganizuar sipas reformës, pjesa tjetër e shoqërive UK janë akoma në proces të përmbylljes së reformës ose nuk i kanë filluar akoma procedurat e riorganizimit për shkak të problematikave nga më të ndryshmet ku kemi akoma:

- shoqëri të cilat nuk janë regjistruar në QKB.
- shoqëri të cilat nuk kanë zgjedhur Këshillin e Administrimit.
- shoqëri të cilat nuk e kanë realizuar procesin e inventarizimit, vlerësimit dhe kontabilizimin e aseteve.

Shoqëritë UK të cilat janë më problematike dhe më të vonuara në kohë për realizimin me sukses të reformës janë:

Sh.a.UK Mallakastër, Sh.a.UK Tropojë, Ndërmarrja UK Kamëz, Sh.a. UK Libohovë dhe Sh.a. UK Dibër (Peshkopi) Sh.a UK Mirditë dhe Ndërmarrja UK Bashkia Pukë konkretisht:

- Sh.a.UK Mallakastër nuk e ka zgjedhur akoma këshillin e administrimit, nuk regjistrohet dot në QKB për shkak të mungesës së dokumentacionit financiarë ndër vite.
- Sh.a.UK Tropojë nuk i ka zgjedhur akoma organet drejtuese dhe është akoma në diskutime. Në lidhje me zonën e re të shërbimit e cila shkon në 8214 banorë, ka probleme

me pesë (5) ujësjellës në varësi të njërive administrative të cilat nuk kanë asnjë të dhënë kontabël të vlerës së tyre.

Shoqëria ka gjithashtu probleme me regjistrimin në QKB sepse:

- nuk ç'regjistrojnë dot Këshillin Mbikëqyrës të mëparshëm, pasi nuk disponojnë dokumentet e identifikimit të anëtarëve të tij.
 - Shoqërisë i janë bllokuar llogaritë bankare si pasojë e gjobave të marra nga organet tatimore, mos pagesës së kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për punonjësit, mos deklarim bilanci dhe si rrjedhojë ju lindin edhe probleme me regjistrimin në QKB.
- Ndërmarrja UK Kamëz nuk është regjistruar akoma si shoqëri aksionare në QKB, nuk ka përfunduar akoma ndarjen me Sh.a.UK Tiranë si dhe nuk ka përfunduar akoma vlerësimin e aseteve të vetë shoqërisë.
 - Sh.a. UK Libohovë funksionon akoma si SH.P.K, nuk regjistrohet dot në QKB për mungesë të dokumenteve të anëtarëve të këshillit mbikëqyrës dhe gjobave të palikuiduara. Aktualisht është në pritje të formularëve nga thesari për të kryer likuidimin e tyre. Shoqëria ka kryer marrjen në dorëzim të zonave të reja.
 - Sh.a. UK Dibër (Peshkopi) i ka zgjedhur organet drejtuese por nuk ka informacion në lidhje me marrjen në dorëzim të zonave të reja dhe regjistrimin e tyre në QKB. Ka dërguar kërkesë në bashki dhe është në pritje të përgjigjes nga ana e tyre për të cilën do na bëjnë me dije (duket që nuk ka një marrëdhënie bashkëpunimi ndërmjet Bashkisë dhe Ujësjiellësit).
 - Sh.a UK Mirditë. e cila nuk e ka ndryshuar akoma formën e administrimit në përputhje me parashikimet e VKM nr. 63 datë 27.1.2016 pasi ka shumë problem me regjistrimin e UK Rubik në QKB dhe më pas të bëjë bashkimin me UK Mirditë.
 - Ndërmarrja UK Bashkia Pukë e ka ndryshuar formën e administrimit në përputhje me parashikimet e VKM nr. 63 datë 27.1.2016 por akoma kjo shoqëri ka probleme me regjistrimin në QKB pasi nuk e regjistrojnë dot statutin e shoqërisë. Shoqëria ka filluar procesin për ndarjen e aseteve të Ujësjiellësit Pukë Fshat i cili ndahet ndërmjet bashkisë Pukë dhe Bashkisë Fushë - Arrëz. por procesi po ecën me ritme shumë të ngadalta për shkak të mungesës së burimeve njerëzore të kualifikuara.
 - Gjithashtu kemi shoqërinë Sh.a. UK Tiranë e cila mund të quhet si një rast i veçantë, ka zgjedhur të funksionojë me Këshillë Mbikëqyrës sipas ligjit për funksionimin e ndërmarrjeve tregtare dhe jo me Këshill Administrimi siç e kërkon vendimi i VKM 63, datë 27.01.2016.

Në tabelën 30. si më poshtë janë renditur 57 shoqëritë UK ekzistuese të cilat ofrojnë shërbimin e furnizimit me ujë dhe kanalizime sipas bashkive përkatëse. Gjithashtu në këtë tabelë kemi edhe

shoqëritë e reja që krijohen sipas ndarjes administrative territoriale për çdo bashki. Numri total i tyre sipas reformës parashikohet të jetë 56 shoqëri UK. Kjo vjen si rezultat i bashkimit të dy bashkive (dy aksionere) në një shoqëri të vetme UK.

Konkretisht janë: bashkitë Berat dhe Kuçovë të cilat e marrin shërbimin UK nga shoqëria Sh.a UK Berat-Kuçovë, bashkitë Librazhd dhe Prrenjas të cilat e marrin shërbimin nga shoqëria Sh.a UK Librazhd, bashkitë Tepelenë dhe Memaliaj të cilat e marrin shërbimin nga shoqëria Sh.a UK Tepelenë, bashkitë Maliq dhe Pustec të cilat duhet ta marrin shërbimin nga Sh.a UK Maliq si dhe bashkitë Konispol dhe Finiq të cilat sipas reformës duhet ta marrin shërbimin e furnizimit me ujë nga shoqëria Sh.a UK Konispol.

Tabela 30. Shoqëritë Ujësjetëlës Kanalizime sipas ndarjes Administrative Territoriale

Nr	Qarku	Bashkia	Qyteti	Shoqëritë U-K ekzistuese	Shoqëritë e reja U-K
1	Berat	Berat	Berat	Sh.a.U-K Berat Kuçovë	Sh.a.U-K Berat Kuçovë
		Kuçovë	i Kuçovë		
		Ura Vajgurore	Ura - Vajgurore	Sh.a.U-K Ura Vajgurore	Sh.a. U-K Ura Vajgurore
		Skrapar	Qyteti Çorovodë	Sh.a.U Çorovodë	Sh.a. U-K Çorovodë
		Poliçan	Qyteti Poliçan	Sh.a.U Poliçan	Sh.a. U-K Poliçan
2	Dibër	Dibër	Peshkopi	Sh.a.UK Peshkopi	Sh.a. UK Peshkopi
		Bulqizë	Bulqizë	Sh.a.U Bulqizë	Sh.a. U Bulqizë
		Mat	Burrel	Sh.a.U-K Mat	Sh.a. U-K Mat
		Klos	Klos	Nuk monitorohet	Sh.a. U-K Klos
3	Durrës	Durrës	Durrës	Sh.a. U-K Durrës	Sh.a. U-K Durrës
		Shijak	Shijak	Sh.a. UK Durrës	Sh.a. U-K Shijak
		Krujë	Krujë	Sh.a. UK Krujë	Sh.a. UK Krujë
4	Elbasan	Elbasan	Elbasan	Sh.a. UK Elbasan	Sh.a. UK Elbasan
		Cërrik	Cërrik	Sh.a. UK Elbasan Fshat	Sh.a. UK Cërrik
		Belsh	Belsh	Sh.a. UK Elbasan Fshat	Sh.a. UK Belsh
		Peqin	Peqin	Sh.a. UK Peqin	Sh.a. UK Peqin
		Gramsh	Gramsh	Sh.a. UK Gramsh	Sh.a. UK Gramsh
		Librazhd	Librazhd	Sh.a. UK Librazhd - Prrenjas	Sh.a. UK Librazhd
		Prrenjas	Prrenjas		
5	Fier	Fier	Fier	Sh.a. UK Fier	Sh.a. UK Fier
		Patos	Patos	Sh.a. UK Patos	Sh.a. UK Patos
		Roskovec	Roskovec	Sh.a. UK Roskovec	Sh.a. UK Roskovec
		Lushnje	Lushnje	Sh.a. UK Lushnje	Sh.a. UK Lushnje
		Divjakë	Divjakë	Sh.a. UK Divjakë	Sh.a. UK Divjakë
		Mallakastër	Ballsh	Sh.a. U Mallakastër	Sh.a. UK Mallakastër

6	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Gjirokastrë	Sh.a. UK Gjirokastrë	Sh.a. UK Gjirokastrë
		Libohovë	Libohovë	Sh.a. UK Libohovë	Sh.a. UK Libohovë
		Tepelenë	Tepelenë	Sh.a. UK Tepelenë	Sh.a. UK Tepelenë
		Memaliaj	Memaliaj		
		Përmet	Përmet	Sh.a. U Përmet	Sh.a. U Përmet
		Këlcyrë	Këlcyrë	Sh.a. UK Këlcyrë	Sh.a. UK Këlcyrë
		Dropull	Fshati Jorgucat	Ndr. Shtetërore U Gjirokastrë	Sh.a. UK Dropull
7	Korçë	Korçë	Korçë	Sh.a. UK Korçë	Sh.a. UK Korçë
		Maliq	Maliq	Sh.a. UK Korçë Fshat	Sh.a. UK Maliq-Pustec
		Pustec	Pustec	I ri	
		Kolonjë	Ersekë	Sh.a. UK Ersekë	Sh.a. UK Kolonjë
		Devoll	Bilisht	Sh.a. UK Bilisht	Sh.a. UK Devoll
		Pogradec	Pogradec	Sh.a. UK Pogradec	Sh.a. UK Pogradec
8	Kukës	Kukës	Kukës	Sh.a. U Kukës	Sh.a. UK Kukës
		Has	Krumë	Sh.a. U Has	Sh.a. UK Has
		Tropojë	Bajram Curri	Sh.a. U Tropojë	Sh.a. UK Tropojë
9	Lezhë	Lezhë	Lezhë	Sh.a. UK Lezhë	Sh.a. UK Lezhë
		Mirditë	Rrëshen	Sh.a. U Mirditë	Sh.a. UK Mirditë
		Kurbin	Laç	Sh.a. UK Kurbin	Sh.a. UK Kurbin
10	Shkodër	Malësi e Madhe	Koplik	Sh.a. U Shkodër Fshat	Sh.a. UK Malësi e Madhe
		Shkodër	Shkodër	Sh.a. UK Shkodër	Sh.a. UK Shkodër
		Vau Dejës	Vau Dejës	Sh.a. U Vau Dejës	Sh.a. UK Vau Dejës
		Pukë	Pukë	Bashkia Pukë	Sh.a. UK Pukë
		Fushë Arrëz	Fushë Arrëz	Sh.a. UK Fushë Arrëz	Sh.a. UK Fushë Arrëz
11	Tiranë	Tiranë	Tiranë	Sh.a. UK Tiranë	Sh.a. UK Tiranë
		Kamëz	Kamëz	Sh.a. UK Tiranë (aktualisht vetadministrohet)	Sh.a. UK Kamëz
		Vorë	Vorë	Sh.a. UK Tiranë	Sh.a. UK Vorë
		Kavajë	Kavajë	Sh.a. UK Kavajë	Sh.a. UK Kavajë
		Rrogozhinë	Rrogozhinë	Sh.a. UK Rrogozhinë	Sh.a. UK Rrogozhinë
12	Vlorë	Vlorë	Vlorë	Sh.a. UK Vlorë	Sh.a. UK Vlorë
		Selenicë	Selenicë	Sh.a. UK Selenicë	Sh.a. UK Selenicë
		Himarë	Himarë	Sh.a. UK Vlorë	Sh.a. UK Himarë
		Sarandë	Sarandë	Sh.a. UK Sarandë	Sh.a. UK Sarandë
		Konispol	Konispol	I ri	Sh.a. UK Konispol-Finiq
		Finiq	Fshati Dermish	Sh.a. UK Sarandë	
		Delvinë	Delvinë	Sh.a. UK Delvinë	Sh.a. UK Delvinë

4. Konkluzione

- Ndihet nevoja e përshpejtimimit të reformës në sektor. Për këtë kërkohet një angazhim më i madh i bashkive, shoqërive të UK dhe të institucioneve të tjera në varësi të qeverisë qendrore që kanë lidhje me sektorin duke vendosur afate dhe klauzola që parashikojnë sanksione në rast mosrespektimi të tyre.
- Në kuadër të reformës së sektorit, aktorët vendorë dhe qendrorë të fushës së ujësjellës kanalizimeve, si dhe institucionet e tjera që lidhen me këto shërbime, të intensifikojnë punën për ndërgjegjësimin e popullsisë me anë të mediave kryesisht vizive në emisione të organizuara posaçërisht për këtë qëllim.
- Të eliminohen barrierat për regjistrimin e shoqërive UK të riorganizuara në përputhje me reformën që në disa raste paraqiten mjaft formale e të tepërta.
- Duke patur parasysh problemet e sektorit në lidhje me kundërvajtësit dhe abuzuesit, ndihet nevoja e plotësimit me akte të tjera nënligjore dhe administrative, si dhe e instrumenteve përkatës për zbatimin e tyre për një zbatim efikas të reformës.
- Të përmirësohet mekanizmi i vlerësimit-planifikim-alokim fondesh nga qeveria qendrore për një periudhë tranzicioni që shoqëritë e riorganizuara UK të mund të përballojnë kostot shtesë nga rritja e zonës së tyre të shërbimit me sistemet e furnizimit me ujë që administroheshin më parë nga ish komunat.
- Rishikimi i legjislacionit për plotësimin e kërkesave ndaj stafit kyç të shoqërive UK që të jenë të diferencuara për shoqëritë e mëdha të mesme dhe të vogla.
- Është e nevojshme që qeveria qendrore të planifikojë dhe alokojë fondet përkatëse për të pajisur të gjithë sistemet e furnizimit me ujë në sektor me ujëmatës të mëdhenj që mundësojnë hartimin e bilanceve të sakta të ujit që krijojnë mundësinë e njohjes së gjendjes reale të kërkesës për ujë dhe administrimin e saj.
- Duke patur parasysh për shoqëritë UK rëndësinë e Planeve të Biznesit 5 Vjeçare, si instrumenta udhërrëfyes me plane veprimi për përmirësimin e performancës së tyre, ndihet e nevojshme që kjo të jetë një prerogativë ligjore për shoqëritë, sidomos për shoqëritë me mundësi të kufizuara financiare, qeveria qendrore të incetivojë financimin e hartimit të tyre.
- Duke patur parasysh fragmentarizimin e sektorit ndihet e nevojshme që qeveria qendrore të shohë si prioritet të afërt fillimin e realizimit të strategjisë së agregimit të shoqërive me një ose dy projekte pilot, aty ku shihet më i mundshëm suksesi, duke respektuar kriteret e vullnetit të lirë të pronarëve si dhe me incentiva nga qeveria qendrore.

5. Aneke: Të dhënat Kryesore të Përzgjedhura

Tabela 31. Tarifatat e Ujit të pijshëm dhe Kanalizimeve

Nr	Aktiviteti	Emertimi	Për Ujin e pijshëm lek/m3			Tarifat shërbimi			Për Ujin e Ndotur lek/m3		
			Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat	Familjare	Buxhetor	Privat
Grupi 1	UK	Tirane	45	120	135	100	100	100	11	30	35
	UK	Durres	61	115	125	100	100	100	37	54	56
	UK	Vlore	30	60	80	80	80	80	11	13	13
	UK	Elbasan (Qytet)	38	115	130				8	25	30
	UK	Fier	52	105	125	200	200	200	13	18	20
	UK	Shkoder	40	110	110	100	100	100	15	20	20
	UK	Berat - Kucove	44	125	125	100	200	200	12	20	20
	UK	Kavaje	38	80	100	100	100	100	15	20	20
	UK	Korce	65	110	140	120	120	120	34	56	56
	U	Elbasan fshat	38	120	120	120	120	120			
Grupi 2	UK	Sarande	52	138	138	150	150	150	20	31	31
	UK	Pogradec	22/62	37/111	37/111	200+100	400+100	400+150	11./33	12./36	12./36
	UK	Lushnje	54	125	135	100	200	200	15	20	22
	UK	Gjirokaster	39	112	124	80	80	80	9	14	14
	UK	Lezhe	58	135	145	200	200	200	18	22	27
	U	Korce fshat	38	90	95	50	50	50			
	U	Lushnje fshat	60	70	100						
	U	Kurbin	30	80	120	50	50	50			
	UK	Librazhd	38	100	100				13	22	23
	UK	Kukes	25	60	80				7	15	20
	U	Shkoder fshat	50	120	120						
	UK	Patos									
	UK	Burrel	23	60	80				2	4	6
	UK	Rrogozhine	48	90	100	50	100	100	10	12	12
	U	Mallakaster									
	UK	Gramsh	32	90	90						
	UK	Kruje	33	80	80				8	12	12
Grupi 3	UK	Tepelene	33	100	120	90	400	250	12	20	20
	U	Peshkopi	27	65	85				10	15	18
	U	Permet	40	110	120	100	100	200			
	UK	Himare									
	U	Bilisht	38	100	110	50	50	50			
	U	Divjake									
	UK	Delvine	48	100	100						
	U	Ura Vajgurore	40	90	100						
	UK	Peqin	30	90	100	50	50	50			
	U	Bulqize	17	55	75	100	100	100			
	U	Novosele	33	50	70						
	UK	Fushe Kruje	28	60	80				6	10	12
	U	Orikum	25	70	75	100	100	100			
	UK	Erseke	38	100	110	100	100	100	10	13	18
	U	Polican	37	80	95						
	U	Tropoje	19	60	80						
	U	Selenice	30	80	100						
	U	Corovode	27	80	95						
	U	Has	25	60	80						
	UK	Mirdite	30	100	115				10	15	15
	UK	Bashkia Puke	35	130	140	100	100	100	8	16	16
	U	Kelcyre									
	U	Vau i Dejes									
	UK	Libohove									
	UK	Rubik	30	70	100				7	10	15
	UK	Fushe Arrez									
	UK	Puke fshat									
	UK	Kraste	30	80	100				7	10	15
	U	Gjirokaster fshat	25	60	60						
	U	Bradashesh									

Tabela 32. Të dhënat e shoqërive UK

Nr.	Aktiviteti	Emri i shoqërisë / nj. admn.	Total i lidhjeve të ujit	Total i lidhjeve kanalizime	Total i të punësuarve që merren me aktivitetet e shoqërisë	Vellimi total i ujit të prodhuar nga dy llojet e sistemeve	Vellimi total i ujit të faturuar tek klientet	Shuma totale e faturuar e Ujit	Shuma totale e faturuar e Kanalizimeve	Shuma totale e faturuar U&K
			nr	nr	nr	000/m3	000/m3	000/leke	000/leke	000/leke
Grupi 1	UK	Tirane	221,149	197,888	1,290	106,144	34,207	2,237,152	445,995	199,178
	UK	Durres	77,870	45,275	645	27,052	7,777	640,524	157,353	45,921
	UK	Vlore	48,174	18,738	333	29,574	5,615	245,887	47,555	19,072
	UK	Fier	32,852	25,536	421	13,405	5,150	393,036	44,064	25,957
	UK	Elbasan	31,395	31,395	205	12,838	3,345	247,142	36,867	31,599
	UK	Berat- Kucove	26,881	21,370	230	17,355	2,872	183,186	25,727	21,601
	UK	Kavaje	24,767	6,090	207	3,089	1,419	81,598	5,876	6,297
	UK	Shkoder	24,046	21,164	270	11,759	3,632	210,793	50,202	21,434
	UK	Korce	24,042	22,202	95	3,544	2,481	210,939	85,329	22,298
	UK	Sarande	17,461	11,290	122	6,187	1,411	120,070	18,165	11,412
Grupi 2	UK	Elbasan (F)	16,451	-	210	3,036	1,972	101,699	-	210
	UK	Pogradec	14,512	10,893	153	1,717	1,186	116,099	22,650	11,046
	UK	UK Lushnje (Q)	11,480	7,572	112	5,320	1,160	82,683	9,566	7,684
	UK	Gjirokaster (Q)	9,802	6,621	121	4,216	1,361	70,783	8,552	6,742
	UK	Lezhe	9,369	9,368	85	2,284	1,196	109,638	22,371	9,453
	U	Lushnje (F)	8,204	-	50	1,221	570	35,337	-	50
	U	Shkoder (F)	7,735	978	142	2,238	1,398	41,847	-	1,120
	U	Kurbin	7,459	-	122	4,198	1,199	46,127	-	122
	U	Korce (F)	6,657	-	54	825	509	25,544	-	54
	U	Patos U	5,862	1,643	148	2,840	1,434	38,431	-	1,791
	U	Bashkia Himare	5,535	1,002	43	1,027	799	33,288	4,699	1,044
	UK	Kukes	5,445	3,492	71	1,984	937	31,537	6,028	3,563
	UK	Peshkopi	5,407	2,815	66	2,276	964	31,182	6,217	2,881
	UK	Librazhd	5,246	4,861	65	876	558	27,013	7,599	4,925
	UK	Belsh	5,048	-	48	605	444	25,360	-	48
	UK	Kruje	4,578	3,463	47	1,354	511	27,381	3,823	3,510
	UK	Mallakaster	4,387	1,497	92	65	497	32,899	2,336	1,589
	UK	Burrel	4,385	3,621	48	1,286	795	39,660	1,867	3,669
	U	Gramsh	4,338	-	45	1,018	706	28,582	-	45
	U	Peqin	4,147	-	87	1,113	606	33,629	-	87
	UK	Tepelene	4,111	3,412	56	1,064	387	21,746	3,364	3,467
	UK	Rrogozhine	4,017	1,532	33	564	176	11,469	524	1,565
	U	Selenice	3,533	-	42	3,426	309	11,907	-	42
	U	Ura-Vajgurore	3,487	-	47	1,160	471	20,950	-	47
	U	Permet	3,425	-	52	535	327	20,021	-	52
	U	Bilisht	3,296	-	30	489	387	19,447	-	30
Grupi 3	U	Divjake	2,909	-	37	399	204	11,011	-	37
	U	Corovode	2,889	1,404	48	738	301	13,500	1,254	1,452
	U	Bulqize U	2,803	-	38	1,289	583	23,846	-	38
	UK	Delvine	2,758	1,660	32	647	240	20,484	1,884	1,692
	UK	Fush-Kruje	2,685	1,787	34	398	210	9,033	1,335	1,821
	U	Tropoje	2,545	-	42	2,558	976	21,374	-	42
	U	Novosele	2,312	-	36	705	327	11,797	-	36
	UK	Erseke	2,032	1,942	22	457	222	13,298	2,062	1,964
	UK	Orikum	1,961	-	18	306	155	6,547	-	18
	UK	Mirdite	1,959	1,605	45	709	283	13,213	2,580	1,650
	U	Polican	1,505	-	44	646	197	10,571	-	44
	U	Has	1,411	-	29	617	294	9,197	-	29
	U	Kelcyre	1,368	-	19	741	166	8,571	-	19
	UK	Bashkia Puke	1,115	1,110	21	586	135	8,158	1,278	1,131
	U	Vau Dejes	969	-	11	673	169	4,460	-	11
	UK	Libohove	764	-	10	523	175	4,341	-	10
	UK	Fush Arrez	611	556	10	362	107	2,967	849	566
	UK	Rubik	574	540	12	133	85	2,911	645	552
	U	Puke fshat	524	78	17	385	98	1,701	182	95

Tabela 33. Të dhënat e shoqërive UK

Nr.	Aktiviteti	Emri i shoqërise / nj. admn.	Te ardhura te fjera operative Ujesjelles	Shuma totale e arketuar nga aktiviteti kryesor i U&K	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Ujesjelles	Kosto Direkte e Operimit (KDO)- Kanalizime	Kosto Direkte e Operimit (KDO) U-K	Kosto Totale e Operimit- Ujesjelles	Kosto Totale e Operimit- Kanalizime	Kosto Totale Ujesjelles - Kanalizime
			000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke	000/leke
Grupi 1	UK	Tirane	578,240	3,026,657	1,656,118	38,401	1,694,519	2,048,060	57,361	2,105,421
	UK	Durres	40,187	611,134	844,685	103,000	947,685	971,979	128,709	1,100,687
	UK	Vlore	13,205	194,215	337,495	70,335	407,830	502,580	89,532	592,112
	UK	Fier	7,397	396,412	335,708	15,613	351,321	408,034	25,813	433,847
	UK	Elbasan	3,727	185,453	219,100	4,230	223,329	301,123	14,446	315,569
	UK	Berat- Kucove	6,984	179,492	144,796	14,458	159,254	203,738	16,893	220,631
	UK	Kavaje	5,126	69,126	117,361	20,748	138,109	175,654	63,990	239,644
	UK	Shkoder	3,270	163,140	195,286	58,056	253,342	244,799	91,224	336,022
	UK	Korce	15,771	213,964	102,779	80,923	183,702	155,511	173,260	328,771
	UK	Sarande	2,898	105,892	106,338	12,611	118,949	148,505	19,914	168,419
	UK	Elbasan (F)	4,223	104,896	168,536	-	168,536	196,587	-	196,587
Grupi 2	UK	Pogradec	4,866	132,487	88,538	34,766	123,304	152,737	122,211	274,947
	UK	UK Lushnje (Q)	3,114	52,735	92,479	7,155	99,634	134,241	10,315	144,556
	UK	Gjirokaster (Q)	5,807	78,311	72,403	6,158	78,561	82,672	7,135	89,807
	UK	Lezhe	3,923	107,608	94,241	16,981	111,222	130,841	89,437	220,278
	U	Lushnje (F)	145	34,798	52,704	-	52,704	78,108	-	78,108
	U	Shkoder (F)	-	32,125	91,712	9,419	101,131	121,207	9,607	130,814
	U	Kurbin	229	43,084	107,269	-	107,269	118,712	-	118,712
	U	Korce (F)	121	20,887	37,779	-	37,779	44,489	-	44,489
	U	Patos U	411	29,648	210,877	-	210,877	223,413	-	223,413
	U	Bashkia Himare	38	24,029	24,545	1,541	26,086	26,755	1,553	28,308
	UK	Kukes	-	26,070	29,517	4,292	33,809	62,654	5,700	68,354
	UK	Peshkopi	87	25,759	29,242	2,949	32,191	31,377	3,947	35,324
	UK	Librazhd	618	33,599	25,190	6,995	32,185	27,985	7,666	35,651
	UK	Belsh	566	28,208	42,733	-	42,733	44,141	-	44,141
	UK	Kruje	158	20,480	31,056	840	31,896	49,115	6,372	55,487
	UK	Mallakaster	1,173	28,140	75,624	1,291	76,915	79,775	2,095	81,870
	UK	Burrel	23	34,392	18,583	1,819	20,402	25,867	2,100	27,967
	U	Gramsh	64	26,371	26,029	-	26,029	34,109	-	34,109
	U	Peqin	1,633	25,989	70,928	-	70,928	75,524	-	75,524
	UK	Tepelene	-	18,846	27,463	1,890	29,353	44,213	1,890	46,103
	UK	Rrogozhine	586	9,164	19,801	2,296	22,097	23,828	2,979	26,807
	U	Selenice	-	10,884	27,948	-	27,948	41,148	-	41,148
	U	Ura-Vajgurore	620	19,996	34,876	-	34,876	41,515	-	41,515
	U	Permet	395	17,931	27,182	-	27,182	29,539	-	29,539
	U	Bilisht	268	12,652	19,876	-	19,876	32,918	-	32,918
Grupi 3	U	Divjake	285	9,861	23,894	-	23,894	25,958	-	25,958
	U	Corovode	451	11,650	30,542	2,891	33,433	37,422	4,373	41,795
	U	Bulqize U	40	17,825	25,441	-	25,441	30,646	-	30,646
	UK	Delvine	112	13,865	28,995	2,799	31,794	49,172	6,609	55,781
	UK	Fush-Kruje	286	6,842	20,818	2,050	22,867	21,981	2,328	24,308
	U	Tropoje	79	12,044	20,401	-	20,401	27,182	-	27,182
	U	Novosele	183	8,153	32,486	-	32,486	37,251	-	37,251
	UK	Erseke	71	13,987	6,920	1,185	8,105	7,838	1,406	9,245
	UK	Orikum	309	5,088	14,525	-	14,525	15,218	-	15,218
	UK	Mirdite	545	8,435	19,754	3,668	23,422	43,052	5,132	48,184
	U	Polican	-	7,963	30,579	-	30,579	33,623	-	33,623
	U	Has	-	6,535	15,576	-	15,576	20,765	-	20,765
	U	Kelcyre	10	6,549	14,355	-	14,355	15,664	-	15,664
	UK	Bashkia Puke	-	8,323	9,243	1,975	11,218	12,570	4,110	16,680
	U	Vau Dejes	-	3,908	16,639	-	16,639	17,704	-	17,704
	UK	Libohove	-	2,825	9,304	-	9,304	10,660	-	10,660
	UK	Fush Arrez	-	2,607	5,832	968	6,800	7,928	1,208	9,136
	UK	Rubik	-	2,432	5,054	1,167	6,221	7,442	1,953	9,395
	U	Puke fshat	-	930	5,911	1,396	7,307	8,431	2,116	10,547

Të sigurojmë për të gjithë konsumatorët në Shqipëri, që ofruesit e shërbimit të furnizimit me ujë dhe kanalizimeve të japin cilësinë më të mirë të mundshme, me një çmim të arsyeshëm dhe në një mënyrë të qëndrueshme financiarisht.

